

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7683 E enjte 18 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Edhe pse mund të duket si paradoks, por është fakt i vërtetë e real. Në vendlindjen e kapitalizmit, populizmi e nacionalizmi i hapi rrugë konkrete ...  
Vijon në faqen 20

Nga VASIL KURETA

Nacionalizmi e populizmi përballë kapitalizmit




Opinion i Ditës

Emri tingëllon disi i vështirë për t'u shprehur: Fondacioni Federal për Përballjen me Diktaturën e Partisë së Unitetit Socialist të Gjermanisë, (SED) ...  
Vijon në faqen 21

Nga MARCEL FÜRSTENAU

Të mos e harrosh kurrë diktaturën



"M'kanë marrë në pyetje, i kam hudhë fare"

**"U mbyll ajo punë. Edhe unë t'kam rraf njëherë", përgjimet e Xhisela Malokut**

Ballafaqimi/ Biseda në prokurori të vajzës që denoncoi Rexhep Rrajën: Nuk flas për ju

Vajza që denoncoi Rexhep Rrajën për dhunë dhe më pas e tërhoqi këtë denoncim, u vu nën një ballafaqim të përgjuar me ish-të dashurin e saj. Përgjimi ambiantal mes të rinjve është kryer në prokurorinë e Krujës, në datën 29 shtator, ndërsa dy të rinjtë janë regjistruar për rreth 2 orë e 30 minuta. Biseda mes të rinjve është regjistruar ...  
Në faqet 8-9

## KRYEMINISTRI PARALAJMERON SHITESAT E 1 PRILLIT 2019: JA KUSH PERFITON RRITJE PAGASH PER MJEKET, MESUESIT DHE USHTARAKET

Projektbuxheti i vitit të ardhshëm: Sektori i shëndetësisë do të ketë shtesë me 10%, 5-7% për rreth 6800 ushtarake në të gjithë vendin. 1 miliard lekë për diasporën



(Në foto) Këshilli Ekonomik Kombëtar

SHKODER

Misteri, gjendet 'fuoristrada' me breshëri plumbash dhe njolla gjaku

Në faqen 7

FLET DEKANI

Filologjiku, ja mundësitë edhe në raundin e tretë të regjistrimeve

Në faqen 10

"HARTA E RE" E TIRANES

Vendimi, u hapet rruga ndërtimeve të Muzeu dhe prapa Pallatit të Kulturës


Në faqen 18

NGA ERJON TASE

Policia përballë sfidave të krimit dhe politikës, libri i ri i Bilbil Memajt

Në faqen 17

PRESIDENTI



**Meta: Kanabisi dhe bastet nuk janë zgjidhje për shqiptarët**

Në faqen 3

Këngëtari arrestohet në një hotel në Linzë. Policia: Pjesë e një grupi kriminal

## Armë dhe kokainë, arrestohet Stresi

Një ditë më parë, i ati i reperit paditi Taulant Ballën për shpifje

Këngëtari Arkimed Lushaj, i njohur si "Stresi" është arrestuar nga efektivi të policisë të Tiranës i akuar për armëmbajtje pa leje. Menjëherë pas ngjarjes, policia e Shtetit ka reaguar me anë të një njoftimi për shtyp për arrestimin e reperit të njohur Arkimed Lushanji i njohur



me emrin e artit, "Stresi". Në njoftim thuhet: "Forca e Ligjit në veprim vë në pranga një nga anëtarët e një grupi kriminal që operon në Tiranë në lidhje me aktivitetin e kundërligjshëm me tendencë "Trafikim narkotikësh" dhe "Krimet kundër personit" ...

Në faqen 11

# LOJRAT E FATIT

## DEBATI

Kryeministri akuza për lojërat e fatit: Peng i një politike shterpësie të ububushme

# Rama: Bastet vdiqën. Berisha: Po krijojnë monopolin e 'bixhozit'

*"1 milion pika të reja do të hapen online"*

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje pasardhësin e tij Edi Rama se bastet nuk do mbyllen, por po krijojnë monopolin e vet të lojërave të bixhozit! "Bastet vdiqën Sali" paralajmëroi kryeministri Rama në përgjigje të akuzave të Berishës se mbyllja e lojërave të fatit po bëhet me qëllim monopolizimin e tyre. Z. Berisha denoncoi përmes qytetarit dixhital se kryeministri po mbyll 9 mijë pika dhe po hap online me celular 1000000 pika të reja bixhozi. Ish-kryeministri këtë e quan një "tmer" teksa publikon mesazhin: "Qytetarët dixhital denoncojnë vëllezërit Rama. Unë jam një punonjës administrate dhe dua ndaj me ju këtë gjurullandinë e ditëve të fundit. Zërat dhe bindjet janë për monopolin e basteve që po krijon Edi Rama për të vëllain Olsi Rama. Është kaq arbitrare mbyllja e kësaj industrie për ta përqendruar në duart e familjes mbretërore. Ndoshta ju mund t'i jepni zë dhe të ndaloni koncesionet që do rrenojnë ekonominë shqiptare dhe që janë bërë model monopolizimi nga familja kryeministrorë. Kaq shumë të papunë sa shtohen përditë vetëm që njerëzit të luajnë bixhoz online me Olsin". Në tri denoncime të tjera dërguar z. Berisha thuhet: "Me gjithë këtë lojë e mbylljes se pikave të basteve, mbrapa fshihet Vangjush Dako, Olsi Rama dhe Gaz Demi. Dritan Jeminaj është figura që kanë vënë për administrator të kompanisë me nipt L71904512F dhe disa ortakëve kukulla nga Turqia. Po zhidukun nga tregu të gjithë biznesmenët, jo për të shpëtuar popullin nga lojërat e fatit, por për t'i përqendruar paratë vetëm në xhepat e Edi Ramës dhe të vëllait. Ju lutem, përpiguni të na kuptoni se na ka shkuar thika në asht". Po dje lidhur me bastet, Berisha publikoi edhe një tjetër denoncim: "Edi Rama do me mbyllë lojërat e fatit dhe bastet sportive që të eci kompania e



Ish-kryeministri Sali Berisha

**SALI BERISHA**  
Ish-kryeministri Berisha denoncoi dje përmes qytetarit dixhital se kryeministri po mbyll 9 mijë pika dhe po hap online me celular 1000000 pika të reja bixhozi. Berisha në një postim në 'Facebook' hedh akuza se bastet nuk do mbylleshin. Ish-kryeministri këtë e quan një "tmer".



Gjatë një seance parlamentare

**EDI RAMA**

"Saliu u del për zot basteve, partia e vet i del kundër kontrollit mjekësor bazë FALAS. Këto janë dy fytyrat kuptimplota të një opozite që ka humbur bastin me të ardhmen dhe ka mbetur peng i një politike të dëshpëruar dyfytërsie e shterpësie të ububushme. Bastet vdiqën Sali".

## "Kap majat, mos u var nga politika"

### Deputeti i PD krijon akademi dixhitale falas për 10 mijë vetë

Deputeti demokrat, Agron Shehaj, njoftoi dje se ka krijuar një akademi dixhitale. "Link Academy" do të trajnojë çdo të ri e të re fushën e IT dhe dixhital marketing, tërësisht FALAS. "Kushdo mund të regjistrohet në kurset FALAS nga data 15 nëntor në programin që synon të aftësojë rreth 10.000 të rinj, të cilët më pas do mund të punësohen në fushën dixhitale. Kjo është një mundësi për të gjithë ata që duan t'ia dalin vetë, pa qenë të varur nga politika", shkruan Shehaj. Ikja e të rinjve, Agron Shehaj



krijon akademi dixhitale falas për 10 mijë vetë: Kap majat, mos u varni nga politika. Të rinjtë shqiptarë duan të ikin një orë e më parë nga ky vend! JO DHE JO! Kjo s'mund të ndodhë! S'mund ta lejojmë kursesi. Me të drejtë, John Kennedy thoshte: "Mos pyesni çfarë mund të bëj ven-

di juaj për ju, pyesni ju çfarë mund të bëni për vendin tuaj". Rruga e vetme për t'ia dalë është investimi mbi arsimin dhe formimin profesional novativ. Për këtë qëllim dua t'ju bëj me dije miq, se kam krijuar një akademi dixhitale. "Link Academy" do të trajnojë çdo të ri e të re fushën e IT dhe Dixhital marketing, tërësisht FALAS. Kushdo mund të regjistrohet në kurset FALAS nga data 15 nëntor në programin që synon të aftësojë rreth 10.000 të rinj, të cilët më pas do mund të punësohen në fushën dixhitale", shprehet z. Shehaj.

Olsi Ramës baste arena. Piktori dështak po bën teatër dhe me lojërat e fatit u dha urdhër që të hiqen nga çdo portal të gjitha, por vetëm bast arena në pronësi të Olsi Ramës nuk u hoq. Uroj që shqiptarët mos t'i besojnë asnjë çfarë thotë ai, sepse po i jep tregun e basteve të afërme dhe për 63 mijë të papunë nuk mban përgjegjësi. Të lutem ma pyet pak për bast arenën. Psa mbylleshin së basteve sportive dhe kazinove në Shqipëri qëndron një kompani turke,

e quajtur basarena, e cila ka vetëm 1 muaj që është licencuar në Shqipëri, kompania ka dhe një Websportivë edukuesin që po bën namnin me reklama, pronarët e bastarenës janë të gjithë turq, por nuk ka shumë informata, mbas 1 janarit kompania në fjalë do ketë monopolin e plot të basteve". Në reagimin e tij Kryeministri Edi Rama akuzon ish-kryeministrin Berisha se po u del për zot basteve. Në një postim në "Twitter", Rama

shkruan: Saliu u del për zot basteve, partia e vet i del kundër kontrollit mjekësor bazë falas. Këto janë dy fytyrat kuptimplota të një opozite që ka humbur bastin me të ardhmen dhe ka mbetur peng i një politike të dëshpëruar dyfytërsie e shterpësie të ububushme. "Bastet vdiqën Sali" paralajmëron shefi i qeverisë në përgjigje të akuzave të Berishës se mbyllja e lojërave të fatit po bëhet me qëllim monopolizimin e tyre.



### Paketa antishpifje, Manjani: Armiku i lirisë, do të mbushë nenet e Enverit

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani reagoi pas propozimit të kryeministrin Edi Rama për një projektligj kundër shpifjeve, ku të gjitha fitimet nga gjyqi të shkojnë për fondin e edukimit. Përmes një mesazhi në "Facebook" Manjani theksoi se Rama ka një armiqësi patologjike me lirinë e shprehjes. Sipas Manjanit, këto nene të Kodit Penal janë bosh, pasi u hoqën në vitin 2012 edhe me votat e Partisë së Ramës. Ai tha se armiku patologjik i lirisë së shprehjes, do t'i mbushë prapë këto nene, që janë aty që prej kohës së diktatorit Enverit. "Besoj e patë dhe mbrëmë se në ç'armiqësi patologjike gjendet sot kryeministri me lirinë e shprehjes. Që nga koha e arrestimit të Aleksandër Frangajt e Martin Lekës, nuk kishim parë një sulm të tillë ndaj gazetarëve! Megjithatë, sa për informacion këto nene të Kodit Penal janë bosh. U boshatisën në vitin 2012 edhe me votat e partisë së kryeministrin. Ishte një nisëm e OSBE dhe e mbështetur nga BE dhe KoE. Synimi ishte i qartë: Askush nuk mund të ndëshkohet pse mendon, beson dhe shpreh ato që mendon për qeverinë dhe shtetin. Armiku patologjik i lirisë së shprehjes, do ti mbushë prapë këto nene, që janë aty që prej kohës së Enverit! Vetëm se i duhen 84 vota...Të fala shumë OSBE, në qoftë gjallë!", shkruan Manjani.



Debati për mbylljen e lojërave të fatit, presidenti: Integrim në tregun e punës

# Kriza, Meta: Kanabisi dhe bastet s'janë zgjidhje për shqiptarët

"Lufta kundër varfërisë nuk zgjidhet me një thes me miell"

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u përfshi dje në debatin për mbylljen e lojërave të fatit, duke përcjellë mesazhin se bastet dhe kanabisi nuk janë zgjidhje për të shpëtuar nga varfëria. Sipas tij, vetëm puna është zgjidhje për të shpëtuar nga varfëria. Me rastin e Ditës Ndërkomëtare të Zhdukjes së Varfërisë, presidenti vizitoi dje fabrikën "City Tex", një biznes social të suksesshëm, ku janë punësuar mbi 100 vajza dhe gra të zonës së Mulletit dhe Petrelës, i shoqëruar nga Shkëlzen Marku i fondacionit "Yunus Social Business Albania" dhe nga përfaqësues të Ambasadës së SHBA-ve dhe të USAID-it. Tematika e Organizatës së Kombeve të Bashkuara e shpallur për vitin 2018 me rastin e kësaj dite të rëndësishme është "Të gjithë së bashku për të ndërtuar një botë gjithëpërfshirëse të respektit universal për dinjitetin dhe të drejtat e njeriut". Në këtë kontekst, gjatë vizitës në fabrikën "City Tex", Presidenti Meta vuri në dukje se Dita Ndërkomëtare për Zhdukjen e Varfërisë duhet të na shërbejë si një reflektim dhe "kanabanë alarmi" për të gjithë, për më shumë përpjekje në luftën kundër kësaj plage të madhe të njerëzimit dhe shoqërisë sonë moderne. "Edhe më parë kam mbështetur këtë lloj aktiviteti, për shkak se është një mundësi shumë e mirë për të integruar gratë dhe vajzat në tregun e punës. Ndaj dhe jam sot këtu te ky biznes social i mrekullueshëm, që po jep kontribut për të luftuar varfërinë, për të integruar gratë dhe vajzat në tregun e punës, si dhe për të siguruar të ardhura të qëndrueshme për dhjetëra familje", - tha Presidenti Meta.



**KANABISI**  
"Të mendojmë të gjithë në këtë drejtim që të kemi një shoqëri më të shëndetshme. Nuk mund të jetë zgjidhje as nxitja e kanabisit apo forma e 'aventura' të tilla, që e dimë se sa shumë i kanë kushtuar vendit dhe familjeve shqiptare. Janë mijëra njerëz që janë nëpër burgje, strese pa fund e shkatërrime familjesh që ka prodhuar ky fenomen".



**BASTET**  
"As bastet nuk janë zgjidhje për të shpëtuar nga varfëria, por vetëm puna e qëndrueshme, me standarde, me përgjegjshmëri të tillë sociale, që ne duhet ta nxisim më shumë duke motivuar ata duke mbështetur ata investitorë, të cilët e tregojnë këtë me shembuj konkretë. Lufta kundër varfërisë nuk zgjidhet as me një thes me miell", tha z.Meta.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, dje në Petrelë

"Luftoni krimin, zgjidhni ngërçin në drejtësi"

## Braktisja e takimit të 13 të MSA, Kukan: Nuk ishte strategji e mirë

Raportuesi në hije për Shqipërinë, Eduard Kukan, shprehet se braktisja e takimit të 13 të MSA-së në Bruksel nga opozita nuk ishte një strategji e mirë, edhe pse opozita ka evidencuar akuzat shumë serioze lidhur me Taulant Ballën dhe se vazhdon të marrë informacione me ato, që ajo i quan si "aktivitete kriminale" të Taulant Ballës. Sado serioze të jenë gjërat, unë mendoj se kjo çështje duhet zgjidhur në Shqipëri, në Kuvendin e Shqipërisë dhe jo të tentohet të zgjidhet në Parlamentin Europian. Në këtë kuptim, vendimi i tyre nuk ishte i drejtë. Më pas, deputetët e opozitës nuk morën pjesë në takim. Gjithsesi, ishte pozitivë që takimi u zhvillua dhe mundëm të shpreheshim. Edhe ne aprovuam një dek-



laratë të përbashkët. Disa amendamente u aprovuan, disa u hodhën poshtë. Do mbetet në histori që në takimin e 13 të komitetit të MSA-së u aprovua një deklaratë e përbashkët e ekuilibruar: Këshilla ime për deputetët e PD-së është kjo: Nëse ata do të kishin qëndruar, do të mund t'i kishin përsëritur akuzat shumë herë. Ata e bënë këtë vetëm një herë dhe pastaj ikën. Nuk mendoj se ishte një

### DREJTËSIA

"Reforma e drejtësisë dhe procesi i vetingut është një reformë shumë e vështirë. Ne e kuptojmë shumë mirë që është e komplikuar. Por ia vlen vërtet që të merren të gjitha masat për zbatimin e saj", tha z.Kukan.



### LSI: Ligji për bastet nuk do të votohet nga mazhoranca

Deputeti i LSI-së, Endrit Brahimllari, shprehu dje bindjen se ligji për mbylljen e basteve nuk ka për t'u votuar nga mazhoranca. Sipas tij, arsyeja pse ky ligj nuk kalon është sepse telefonatat që përmend Rama i shkojnë drejtpërdrejtë atij dhe jo deputetëve. "Unë jam i bindur se ky ligj nuk kalon as me votat e kësaj mazhorance. Ato telefonatat nuk u shkojnë deputetëve të tij, por vetë kryeministrit Edi Rama. LSI është qartazi e pozicionuar në opozitë së bashku me PD-në dhe një front opozitar dhe janë të gjithë kundër këtij kryeministri", tha Brahimllari.

### Paloka: Rama e Arta Marku duhet të ishin në burg

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka shprehet se kryeministri dhe prokurorja e përgjithshme e përkohshme, Arta Marku duhet të ishin në burg. Paloka kujton deklaratat e kryeministrit për ekspertizën e zërit të Agron Xhafajt dhe vendosi që nuk ishte i tij. Rama ka parë edhe kamerat e komisarariatit të Fushë-Krujës dhe vendosi që Balla dhe Rraja nuk kanë qenë në komisarariat. Rama dhe Arta Marku duhet të ishin në burg vetëm për këtë, po ndërkohë njëri është në krye të qeverisë, e tjetra në shërbim të tij, në krye të Prokurorisë", shkruan Paloka.

është pozitive, por rruga e sigurt dhe e qëndrueshme është rruga e integritetit në tregun e punës. Kjo është e vetmja rrugë që secili të ketë një jetë të qetë, një jetë të sigurt dhe të kontribuojë për zhvillimin ekonomik të familjes së tij dhe komunitetit ku bën pjesë. E ardhmja e Shqipërisë janë këto aktivitete, janë shërbimet, por në mënyrë të veçantë janë turizmi, bujqësia dhe agroturizmi", - theksoi z.Meta. Presidenti falënderoi mbështetjen

e USAID për këtë biznes, që siç tha ai, duhet të kthehet në një model motivues për shoqërinë shqiptare. "Gëzohem shumë që shoh shumë vajza të reja këtu dhe ky është një tregues shumë i mirë dhe shumë pozitiv. Falënderoj USAID-in dhe qeverinë amerikane për ndihmën dhe mbështetjen që i jep këtij biznesi social dhe duhet të bëjmë çdo gjë që edhe ne të kontribuojmë më shumë për t'i shumëfishuar këto lloj biznese, për t'i bërë një mod-

el udhëheqës dhe motivues për të gjithë shoqërinë, mënyrë që të mos respektohet më ai që është më i fortë, ai që është më i parregullit, ai që shkel rregullat e lojës, por në këtë shoqëri duhet të respektohen njerëzit që sjellin vlera, njerëzit që tregojnë kujdes për ata që janë më në vështirësi, që u japin dorën, që i integrojnë dhe që i ndihmojnë të ecin vetë në jetë me mundësitë e tyre dhe me dinjitetin e tyre", - u shpreh z.Meta.

# PADITË PËR SHPIFJE REAGIMET

Kreu i Grupit të PS: Kemi rivendosur komunikimin me PD për reformën zgjedhore

## PD akuza Ballës për udhëtimet me çarter, deputeti i PS: Padi edhe për Strazimirin

Balla paditi për shpifje Bashën, Salianjin dhe Hoxhën

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla ka bërë një tjetër padi të re ndaj kreut të PD, Lulzim Basha, deputeti Ervin Salianji dhe ish-kreut të policisë bashkiake Florenc Hoxha, ndërsa ka njoftuar edhe padinë ndaj deputetit tjetër të PD-së, Gent Strazimirin. Balla ka dorëzuar padinë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për kallëzim të rremë në lidhje me akuzat e çështjes së vëllait të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Tre zyrtarët e PD akuzohen për veprën penale "Shpifje" dhe "kallëzim të rremë". "Pas depozitimit të kallëzimit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, mësova se të kallëzuarve të sotëm u ishte shtuar me vullnetin e tij të plotë prej shpifësi, Gent Strazimirin. Të cilin ju informoj publikisht se do ta bashkoj me shokët e vet në radhën e shpifësve të kallzuar prej meje. Plan i kontributeve nga xhepat e shpifësve për Fondin e Edukimit, ecën për bukuri. Mirëpresim shpifësin e radhës", u shpreh Balla. Reagimi i Ballës erdhi pas akuzave të deputetit demokrat, Gent Strazimirin.

Strazimirin tha se Balla hesht dhe nuk jep shpjegime lidhur me paratë që sipas PD-së, Balla ka shpenzuar për udhëtime me Charter me biznesmenin e dënuar për trafik droge, Edmond Bego. Strazimirin ka thënë sot se opozita nuk do të bëhet fasadë e qeverisë. "As në Bruksel, as në Tiranë, opozita nuk ka për të luajtur teatrin që i duhet Edi Ramës, për t'u bërë fasada e pushtetit absolut të kimit të organizuar. Taulant Balla u vetëshpall njeriu i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, por krahu i djathtë i Edi Ramës nuk ka dhënë akoma asnjë përgjigje për 57 udhëtimet në Europë me Edmond Begon, mikun e tij trafikant ndërkombëtar droge. Taulant Balla, i cili jep opozitës leksione europianizmi, nuk ka shpjeguar akoma se ku i ka gjetur lekët për të udhëtuar me charter bashkë me Edmond Begon. Ligji e ndalon Taulant



Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla

**PADIA**  
Tre zyrtarët e PD akuzohen për veprën penale "Shpifje" dhe "kallëzim të rremë". "Pas depozitimit të kallëzimit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, mësova se të kallëzuarve të sotëm u ishte shtuar me vullnetin e tij të plotë prej shpifësi, Gent Strazimirin.

### Babalja, ish-kreu i policisë bashkiake të Tiranës në prokurori

## Florenc Hoxha pranon regjistrimin e Alizotit: Dyshova se m'u vetofrua në takim

Ish-kreu i policisë bashkiake Florenc Hoxha ka pranuar dje, para prokurorëve se ka qenë ai personi që realizoi videon me Fredi Alizotin, i cili thuhet se është autori që imitoi vëllain e Xhafajt, Agron Xhafajin. Hoxha pohoi se e kishte regjistruar në muajin qershor Alizotin me një kamera në orë dore, pasi kishte dyshuar për faktin se pse ai i ishte vetëofruar në takim. Sipas gazetares Klodiana Lala, Hoxha mësohet të ketë thënë: "Dyshova se Alizoti m'u vetëofrua dhe e regjistrua. E regjistrua me një kamera në orë dore". Pas dëshmisë Hoxha dorëzoi në prokurori dhe orën me



të cilën ka bërë regjistrimin. Hoxha dha llogari për videon e dytë të publikuar nga deputeti i PD-së Ervin Salianji, ku shfaqet Fredi Alizoti në një tjetër dëshmi për këtë çështje, ndërsa implikonte emrin e Taulant

Ballës dhe drejtorit të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu. Pasi doli nga ambientet e prokurorisë, Hoxha nuk dha asnjë deklaratë për mediat, ndërsa tha se: 'ua sqaron prokuroria'.

Ballën të marrë dhuratë mbi 100 mijë lekë, ndërkohë që i udhëtim me charter kush-ton të paktën 30 mijë euro".

### REFORMA ZGJEDHORE

Nga ana e tij, pavarësisht sherrit në Bruksel kreu i grupit socialist Taulant Balla tha se PS dhe PD kishin vendosur tashmë komunikimin për reformën zgjed-

hore. "Dialogu zhvillohet në institucione. Besoj që kemi rivendosur komunikimin për sa i përket kodit zgjedhor dhe në të njëjtën frymë duhet të diskutojmë dhe për çështje të tjera të rëndësishme", tha dje, në një dalje për mediat, Balla. "Ajo shfaqja e turpshme në PE le të jetë një akt i fundit i sjelljes në vite të ndryshme të gjithë politikës shqiptare në Bruksel. Nuk ka pasur dhe

nuk ka një vend tjetër në rrugën e anëtarësimit në BE apo në të njëjtën fazë me ne të procesit të integritetit, që opozita të shfrytëzojë mikrofonat e sallave të PE, apo të Këshillit, apo të Komisionit, për të sharë vendin e vet. Kemi çfarë kemi, duhet t'i diskutojmë këtu. Sjellje si ajo e kryetarit të Komisionit të Integritetit nuk i bëjnë nder Shqipërisë", tha Balla.



Këshilli Ekonomik Kombëtar

### Moshapja e hetimeve nga prokuroria për Ramën, Vasili: Akt i paligjshëm

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së tha dje, se vendimi i prokurorisë për të mos filluar hetimet për Edi Ramën, është militant, i paligjshëm dhe i lajthitur. Vasili ka sqaruar se prokuroria sipas opozitës ka bërë një gabim pasi kallëzimi është bërë nga Edmond Spaho dhe Vasili, jo nga Partia Demokratike, siç shkruante dje prokuroria në vendimin për mos nisjen e hetimeve. "Prokuroria e Përgjithshme e ka vendosur këtë mos kallëzim, duke pretenduar që Edi Rama përfundimisht i është drejtuar një laboratorit privat si një person privat dhe ka thënë praktikisht, tekstualisht këto fjalë: Prova e paraqitur që pretendohet në kallëzim, kallëzimin e bërë prej nesh është një analizë shkencore thotë prokurori, e marrë nga një laborator privat nga palë private. Prokurori s'ka bërë asgjë tjetër përveç se ka firmosur atë që është bërë gati në zyrën e kryeministrit", u shpreh Vasili. Një ditë më parë prokuroria ka vendosur që të mos hapë hetimet për kryeministrin Rama, pas deklaratave të tij se përgjimi i Albert Veliut ishte i montuar.



### Kreu i OSBE-së thirrje opozitës: Të kthehet në Kuvend për reformën zgjedhore

Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Bernd Borchardt, i nxitu të gjitha partitë politike të intensifikojnë diskutimet dhe të gjejnë një kompromis për reformën zgjedhore. I pyetur lidhur me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, ai veçoi disa prej tyre si depolitizimi i administratës zgjedhore, çështja e kronikave televizive të përgatitura nga vetë partitë, dhe dekriminalizimi i shpifjes. Lidhur me votimin dhe numërimin elektronik, Borchardt tha në një intervistë për Klan Plus se, nëse partitë bien dakord për këtë, vendimi duhet marrë shpejt, për shkak se proceset e blerjes dhe instalimit të pajisjeve, trajnimet të administratës dhe edukimit të zgjedhësve kërkojnë kohë. "Shoh që debati po bëhet gjithnjë e më i gjallë. Njëra nga palët ka paraqitur një draft dhe unë i nxis të gjitha partitë politike që tani të intensifikojnë diskutimet dhe të gjejnë një kompromis, në mënyrë që gjithsecili të japë këndvështrimin e tij politik për ndryshimet e Kodit Zgjedhor", tha Borchardt duke i kërkuar opozitës të kthehet në Kuvend.







Zbardhet vendimi për masën e shtesës së pagave për të tri kategoritë

# Rama: pas 1 prillit, rritje pagash për mësuesit, mjekët e ushtarakët

Përfitojnë 18415 mjekë e infermierë, 350 mijë arsimtarë dhe 6800 ushtarakë

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama paralajmëroi dje, rritje pagash për arsimtarët, infermierët dhe ushtarakët pas 1 prillit 2019. Në mbledhjen e Këshillit Ekonomik Kombëtar, ku u diskutua për projektbuxhetin e vitit 2019, kryeministri Rama u shpreh se në sektorin e shëndetësisë do të bëhet rritja më e lartë, prej 10%. "Në sektorin e arsimit do të kemi një tjetër rritje të konsiderueshme prej 7%. Janë 4650 mjekë dhe 13765 infermierë në të gjithë vendin, përfshihen edhe laborantët dhe farmacistët e spitaleve, si dhe 350 mijë arsimtarë që do përfitojnë nga këto rritje. Po ashtu do kemi një rritje në sektorin e mbrojtjes për 6800 ushtarakë në një masë që do të variojë sipas kategorive, 5%-7%", sqaroi kryeministri. "Brenda strukturës së buxhetit, ju do të shikoni që ky buxhet nuk është thjesht buxheti më i madh i radhës, por është një buxhet i rritja e të ardhurave, krahasuar me vitin aktual, është shumë domethënëse dhe në raportin brenda për brenda kornizës së buxhetit është më domethënëseja, krahasuar me buxhetet e mëparshme, pothuajse 300 milionë dol-

### RRITJA E PAGAVE

Në sektorin e shëndetësisë rritje prej 10%.  
Në sektorin e arsimit do të kemi një rritje prej 7%.

Janë 4650 mjekë dhe 13765 infermierë në të gjithë vendin, përfshihen edhe laborantët dhe farmacistët e spitaleve, si dhe 350 mijë arsimtarë që do përfitojnë nga këto rritje.

Rritje 5-7% rritje page në sektorin e mbrojtjes për 6800 ushtarakë

Janë afro 30 mijë familje që do të përfitojnë nga një fond për rreth 20 milionë dollarë

Ngrihen 27 shërbimeve të reja të kujdesit social dhe qendrave në mbështetje të shtresave më të prekura, këtu përfshihen një sërë elementesh për 69 mijë familje.

### PAKETA FISKALE

- Rritje e kufirit të pagës të tatueshme që sot është në nivelin nga 1.2 deri në 1.5 milionë.
- Ujje të dividendit në masën 8%.
- Zgjerim i përjashtimit të TVSH-së së importit të makinerive bujqësore që shkon për makineri dhe pajisje të reja. Kemi një reduktim takse për importuesit e autobusëve elektrike.
- Përfshihen nga TVSH-ja të gjithë nënkontraktorët në industrinë fason, apo importues të lëndëve të parë për prodhim farmaceutik, që janë dy kontradikta të rënda që kanë qenë vazhdimisht dhe kanë krijuar shumë konfuzion.
- rritet tavan i xhiros për biznesin e vogël, që shkon nga 80-140 milionë xhiro, është vetëm 5% tatim-fitimi.
- Ujje e borxhit 65.3% në vitin 2019

sur disa zhvillime pozitive për vendin dhe kështu ka qenë edhe për rritjen e pagave më parë, kështu do të jetë përsëri, për mjekët, për infermierët, për mësuesit dhe për ushtarakët. Sipas kryeministrit, "buxheti i ri do të mbështesë dhe një numër politikash të reja që nga ndërmarrjet sociale, si program alternativ integrimi për grupet e pafavorizuara, me target punësimin e personave në nevojë, tek ngritja e 27 shërbimeve të reja të kujdesit social dhe qendrave në mbështetje të shtresave më të prekura, tek familjet përfituese të ndihmës ekonomike me paketat social-shëndetësore dhe këtu përfshihen një sërë elementesh për 69 mijë familje". Rama tha se janë parashikuar rreth gjysmë miliardë lekë në buxhet për të mbështetur qoftë infrastrukturën e rrugëve kombëtare, qoftë infrastrukturën e ujësjellësve, si dhe trajtimin e mbetjeve, rehabilitimin e mëtejshëm të rrjetit energjetik.

Ai tha se do të rindërtohet i gjithë rrjeti i qendrave shëndetësore. "Janë 100 qendra të tjera, pas 80 të parave, që janë në punë e sipër dhe që do të përfundojnë deri në fund të vitit. Janë 100 qendra të tjera shëndetësore që do të rindërtohen gjatë vitit të ardhshëm, ose do ndërtohen nga e para, si dhe disa projekte të tjera për spitalet.

## Qeveria miraton 1 miliard lekë për diasporën

Këshilli i Ministrave ka miratuar në mbledhjen e djeshme një vendim duke akorduar 1 miliard lekë për financimin e projektit "Diaspora për Zhvillim" me kohëzgjatje 36 muaj. Fondi 100 590 600 (1 miliard lekë të vjetra) përfshin këtë vit dhe deri në 2021, ndërsa specifikohet shuma për çdo vit. Për pjesën e mbetur të vitit 2018, të vihet në dispozicioni fondi prej katër milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë lekësh. Për vitin 2019, të vihet në dispozicioni fondi prej dyzet e katër milionë e nëntëqind e një mijë e tetëqind e dyzet e katër lekësh, për vitin 2020, të vihet në dispozicioni fondi prej tridhjetë e dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë lekësh dhe për vitin 2021, vihet në dispozicioni fondi prej nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë lekësh.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një makine numëruese dhe paketuese për monedhat metalike, si dhe shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,060,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
STANALTR  
BIC: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshtkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një makine numëruese dhe paketuese për monedhat metalike, si dhe shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 08 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,996,800 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshtkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 09 Nentor 2018, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**ELBASAN** - Tre persona janë arrestuar nga policia e Elbasanit gjatë operacionit të koduar "Sezoni". Mësohet se personat e vënë në pranga, ushtronin ndikim të pedagogët e universitetit "Aleksandër Xhuvani" për të vendosur nota kaluese kundrejt pagesës. "Pas një hetimi 2 muajor, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Njësinë e Forcës së Poshtme, pranë



## Merrnin para në këmbim të notës kaluese, përfundojnë në pranga tre sekserë

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit u bë i mundur dokumentimi i ligjor i aktivitetit kriminal dhe ekzekutimi i urdhrat për ndalimin e të dyshuarve për krim dhe konkretisht: Skënder Stafa, 46 vjeç, lindur dhe banues në fshatin Precë e poshtme, Njësia Administrative

Funar, Bashkia Elbasan; Q.M., 49 vjeç, lindur në Shikaj Kukës dhe banues në Mëzez-Fushë, Njësia Administrative Kasash, Tiranë si dhe Medi Hana, 50 vjeç, lindur dhe banues në Skënderbë, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Përrenjas. Ndalimi i personave të sipërpërmendur u bë

për kryerjen e veprës penale 'Ushtrimi të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike', thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, burime nga prokuroria pohuan se janë nën hetim edhe tre pedagogë, emrat e të cilëve nuk bëhen të ditur për arsye hetimore.

"Të ngrihet një kantier për riparimin e mjeteve tona lundruese"

# Amortizimi, peshkarexha 60 ton fundoset në kalatën lindore të portit të Durrësit

*Peshkatarët: Situata alarmante, 50 për qind e flotës së peshkimit është në rrezik mbytjeje*

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Një anije peshkimi 20 m e gjatë me tonazh 60 ton është mbytur mëngjesin e djeshëm në portin e Durrësit. Bëhet fjalë për peshkarexhën

"Klodi" me pronar Adem Pojana, e cila u fundos në kalatën lindore vetëm pak minuta pasi ishte sjellë aty nga deti ku kishte pësuar defekt. Burimet zyrtare nga Kapiteneria e Portit të Durrësit bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se pronari i anijes kishte kërkuar ndihmën e rimorkiatorit për ta ankoruar në breg peshkarexhën, pasi kishte pësuar defekt. Mësohet se anija e peshkimit është ankoruar në kalatën lindore aty ku ndodhej ish-kantieri i riparimit të anijeve, por ajo është fundosur, pasi kishte futur shumë ujë në ambientet e brendshme të saj. Taulant Allka, kapiteni i portit të Durrësit tha se kapiteni i anijes po punon dhe ka kontraktuar vinçat për të nxjerrë anijen e për të bërë riparimin e saj. Në portin më të madh të vendit, problemi me i madh i të gjithë industrisë së peshkimit është mungesa e një kantieri detar për riparimin e anijeve të peshkimit. Ish-kantieri ku ndërto-



Vendi u fundos peshkarexha

heshin dhe riparoheshin anijet u privatizua nga një kompani private, e cila në mënyrë arbitrare shkatëroi kantierin duke e çuar për shkrije në metalurgjikun e Elbasanit. Në mungesë të kantierit për riparimin e anijeve, armatorët durrsakë janë të detyruar të riparojnë mjetet e tyre lundruese jashtë vendit, ku kostoja është disa herë më e lartë. Të ndodhur në një situatë të tillë, peshkatarët e Durrësit kërkojnë ndërelimin e një kantieri detar për riparimin e anijeve të tyre. Ata thonë se 50 për qind e flotës së peshkimit është në rrezik mbytjeje, pasi anijet janë amortizuar plotësisht nga mungesa e riparimeve. "Shumë investitorë të huaj janë ofruar në port për të ngritur një kan-

tier, i cili është biznes i sigurt dhe fitimprurës, por deri tani autoritetet shtetërore nuk u kanë dhënë atyre hapësirat e nevojshme në këtë fushë. Flota është drejt rënimit total, në situatën ku

gjendet 10 vitet e fundit. Edhe një muaj më parë, një anije peshkimi e Durrësit u mbyt në grykëderdhjen e Semanit për shkak të amortizimit", u shprehën peshkatarët e Durrësit.

### ALARM!

Peshkatarët e Durrësit dje u shprehën për "Gazeta Shqiptare" se shumë investitorë të huaj janë ofruar në port për të ngritur një kantier, i cili është biznes i sigurt dhe fitimprurës, por deri tani autoritetet shtetërore nuk u kanë dhënë atyre hapësirat e nevojshme në këtë fushë. "Ata dhanë alarmin duke thënë se flota është drejt rënimit total, në situatën ku gjendet 10 vitet e fundit".

### LOJERAT E FATIT

4000 sallone bastesh informale janë të pakontrolluara

Ligi i hartuar në vitin 2015 për lojërat e fatit, dhe i ndryshuar në parlament, solli reduktimin e numërit të kazinovave elektronike, por në anën tjetër bastet sportive u përhapën në çdo pallat, shkollë dhe institucion. Sipas të dhënave zyrtare nga Autoriteti Mbikqyrës i Lojrave të Fatit, numri i pikave të basteve deri në fund të vitit 2017 ishte 4466 në total. Po kaq është edhe numri i pikave të basteve ilegale, që punojnë në treg të zi, pa asnjë kontroll. Erion Braçe, i intervistuar nga Top Story, thotë se asnjë kompani bastesh nuk kontrollohet online nga kompania që qeveria ka kontraktuar. "Asnjë kompani bastesh, asnjë kompani bastesh, qofshin me licensë apo me nipte sekondare, nuk është e lidhur në rrjet. Dhe xhiroja e tyre nuk kontrollohet online përmes kompanisë që qeveria ka kontraktuar", tha Erion Braçe.

## Myftiu Artur Vrenoz: Të kapen autorët!

### Sulmohet xhamia e Bilishtit, autorët thyejnë xhamat e objektit të kultit



statur sulmin. "Ditën e djeshme kur erdhi imami i xhamisë i qendrës Bilisht

i rëndomtë në këtë xhami. Brenda javës është hera e dyte që ndodh dhunimi i objekteve të kultit, siç ishte dhe rasti në Dishnicë. Qëllimin nuk e dimë, por është dhunim i rëndomtë. Na shqetëson shumë fakti se ngjarja mbetet pa autorë. Komisariati i Devollit bëri verifikimet, shpeshojmë të gjejmë autorët", deklaroi Vrenoz. Ndërkaq, policia po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

**SHPPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 09.11.2018 8 ora 8<sup>pm</sup> - 16<sup>pm</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II për shijën e pasurisë të paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1500 m<sup>2</sup> me numër pasurie 6/90, volumni 9 , faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi. Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare ne ankand 17.640 (Shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



Dyshohet që shënjestra të ketë qenë Artan Koçeku, i akuzuar për vrasjen e Angelin Shkambit

Senad Nikshiqi

SHKODËR

# Misteri, gjendet fuoristrada e qëlluar me breshëri plumbash e me njolla gjaku brenda

## Automjeti me targa false ishte braktisur në fshatin Shtoj i Vjetër, "zhduket" i plagosuri

Një makinë e qëlluar me armë zjarri dhe me njolla gjaku brenda është gjetur nga policia e Shkodrës në orët e para të mëngjesit të së hënës në fshatin Shtoj i Vjetër të njësins Rrethina. Mësohet se mjeti tip "fuoristradë" me ngjyrë të kuqe që u gjet në afërsi të shpallur të trenit është qëlluar me breshëri plumbash dhe me pas është lënë e braktisur. Momentalisht dyshohet se një person që ka qenë brenda makinës është plagosur. Ndërkohë që deri tani ende nuk ka asnjë lloj informacioni sekuks është plagosur dhe ku ndodhet ai. Ndërkaq, burime nga vendi i ngjarjes, por edhe burime nga policia lokale bënë dje me dije se dyshohet që brenda makinës të ketë qenë një person problematik, i cili ka qenë objektivi i autorëve të krimit. Blutë kanë shoqëruar shumë persona në zonën ku ka ndodhur ngjarja, ndërsa janë marrë në pyetje shumë të tjerë për të hedhur më shumë dritë mbi atë që ka ndodhur. Një prej të dyshuarve kryesor, por jo i vetëm sipas burimeve nga vendngjarja dhe policisë është edhe shtetasi Artan Koçeku. Ky i fundit është person i shpallur në kërkim që në dhjetorin e 2017-ës si autor i dyshuar për vrasjen e Angelin Shkambit, ngjarje kjo e ndodhur tek varrezat e Stom Golemit në Shkodër. Kjo vrasje dyshohet nga policia se erdhi pas një borxhi me viktims dhe autorit për pazare droge.

HETIMET

Sipas hetuesve të çështjes, fuoristrada, e cila është qëlluar me breshëri plumbash natën e 14 tetorit të këtij viti rezultoi se ka targa të vjedhura dhe të mbivendosura. Nga ana tjetër, pohohet se në spitalin rajonal të Shkodrës që nga nata e 14 tetorit nuk ka shkuar asnjë person i plagosur me armë. Vendi ku ka ndodhur ngjarja është një rrugë dytësore që nuk ka qarkullim të shpeshtë dhe larg vëmendjes së njerëzve, detaje këto që e vështirëzojnë punën e policisë. Ndohëse ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të së hënës, policia e ka mbajtur të fshehur deri ditën e djeshme. Ndryshe nga rastet e tjera, kjo ngjarje nuk është dhënë në njoftimin për shtyp. Nga ana tjetër, blutë po hetojnë për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje. Konkretisht, po hetohet për identifikimin e personave që kanë qëlluar me armë zjarri fuoristradën si dhe për të gjetur nëse personi i plagosur është i dyshuari Artan Koçeku apo ndonjë tjetër. Në vendngjarje janë ende disa pjesë të shiritit të policisë që ka rrethuar zonën



Fuoristrada e qëlluar nga plumbat



Vendi ku ndodhi ngjarja



Kontrollet, arrestohet 39-vjeçari dhe shoqërohen 10 të tjerë

SHKODËR - Policia e Shkodrës dhe FNSh kanë zhvilluar aksione të befasishme në qytetin verior për kapjen e personave të kërkuar apo të atyre që qarkullojnë të armatosur. Mësohet se gjatë kontrollve u arrestua në flagrancë një 39-vjeçar dhe u shoqëruan në komisarjat për verifikim 10 persona. I arrestuari është Blerim Beqiri nga fshati Oblikë i Shkodrës. Ai u kap në një lokal, pasi policia i gjeti në trup një pistoletë të mbushur me fishekë në fole. Ndërkaq, gjatë kontrollit në banesë, iu gjetën dhe iu sekuestruan edhe 370 fishekë luftarakë model 56. Materiale në ngarkim të 39-vjeçarit iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprën penale "Mbahjtja pa leje dhe prodhimi i armëve, shpërblyes dhe i municionit".

DYSHIMI

Blutë kanë shoqëruar shumë persona në zonën ku ka ndodhur ngjarja, ndërsa janë marrë në pyetje shumë të tjerë për të hedhur më shumë dritë mbi atë që ka ndodhur. Një prej të dyshuarve kryesor, por jo i vetëm sipas burimeve nga vendngjarja dhe policisë është edhe shtetasi Artan Koçeku. Ky i fundit është person i shpallur në kërkim që në dhjetorin e 2017-ës si autor i dyshuar për vrasjen e Angelin Shkambit, ngjarje kjo e ndodhur tek varrezat e Stom Golemit në Shkodër. Kjo vrasje dyshohet nga policia se erdhi pas një borxhi me viktims dhe autorit për pazare droge.

KUSH ËSHTË ARTAN KOÇEKU

Artan Koçeku është një person i skeduar si kontigjent krimi për policinë e Shkodrës. Në vitin 2013, ai së bashku me 3 persona të tjerë u arrestuan me akuzat: "Vjedhje të pasurisë", "Vjedhje me armë në bashkëpunim" dhe "Shkatërrim prone" me eksploziv. Koçeku është i akuzuar për disa vjedhjen me armë të pikave të karburantit në Shkodër, Lezhë e Malësi e Madhe si dhe të 12 dyqaneve. Gjithashtu, ai akuzohet edhe për një ngjarje së ndodhur më 19 shkurt të vitit 2013, ku i vendos lëndë eksplozive automjete të punonjësit të policisë Pavlo Vuksani, i cili po merrej me hetimin e tij për vjedhjet e kryera.

ku ka ndodhur ngjarja si edhe dorezat e ekspertëve të grupit hetimor. Po ashtu është arritur që të sigurohet edhe një foto e fuoristradës të qëlluar me breshëri plumbash.

VRASJA NË 2017-ËN

Paraditen e 17 dhjetorit të vitit që shkoi, në varrezat e Stom-Golemit u vra 32-vjeçari Angelin Shkambi. Policia e Shkodrës në bashkëpunim me prokurorinë e këtij rrethi, pas veprimeve hetimore kanë bërë të mundur identifikimin dhe shpalljen në kërkim të Artan Koçekut nga fshati Pog, si autor i dyshuar për ekzekutimin e Shkambit. Pas ngjarjes, blutë pohan se 27-vjeçar i dyshuar ka qenë me leje shpërblymi nga burgu i Peqinit, ku vuante dënimin për disa ngjarje të ndodhura në vitin 2013, për veprën penale "Vjedhja me armë". Po të njëjtat burime thanë në atë kohë se ngjarja dyshohet të ketë ndodhur si pasojë e një konfliktit për shkak të një borxhi prej rreth 30 mijë euro

që autori i dyshuar, Artan Koçeku i ka pasur viktims Angelin Shkambi. Sipas hetuesve të çështjes, autori ka pasur një komunikim me telefon me viktims përpara se të ndodhte ngjarja dhe të dy bashkë janë takuar tek varrezat e Stom Golemit për t'u sqaruar mes njëri-tjetrit. Pas një debati mes tyre në makinën e viktims, Artan

Koçeku dyshohet se ka qëlluar me pistoletë në drejtim të Angelin Shkambit. 32 vjeçari mori 3 plumba, dy kokë dhe një në shpatull dhe për pasojë gjeti vdekjen e menjëhershme. Borxhi prej 30 mijë euro që autori i kishte viktims sipas burimeve policore dyshohet se është për shkak të pazareve të drogës. Angelin Shkambi në prill të

2017-ës u arrestua si pjesë e operacionit "Early Spring" ku në pranga ranë 17 persona të akuzuar si autorë të parcelave me rreth 100 mijë rrenjë cannabis sativa të asgjësuar nga policia në Dukat. Më pas nga "Arrest me burg" në Shkallën e Parë, gjykata e Apelit dha ndaj tij masën lehtësuese "Detyrim me paraqitje".

## Sherr mes 4 të rinjve në Dibër, njërit i gjendet drogë e armë në banesë



DIBËR - Një ngjarje e mundshme kriminale është parandaluar dje nga policia e Dibërs, pasi morën informacion për një konflikt mes 4 të rinjve në qytetin e Peshkopisë. Mësohet se shtetasit: H.K. 25 vjeç dhe M.K. 21 vjeç, pas një sherri për motive të dobta goditën me mjete të forta A.S. 25 vjeç dhe D.M. 24 vjeç duke u shkakuar lëndime, e më pas i kërcënuan me armë. Ndërhyrja në kohë e uniformave blu parandaloi përshkallëzimin e konfliktit. Dy autorët e dyshuar mundën

të arratiseshin kur panë policinë, dhe aktualisht janë shpallur në kërkim. Ndërkaq, blutë bënë me dije se gjatë kontrollit në banesën e 25-vjeçarit me iniciale H.K. u gjet dhe sekuestrua 2 kg lëndë narkotike kanabis sativa. Në këto kushte, u arrestua babai i të riut, Lutfi Kaja për prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike. Po kështu u gjet edhe arma e zjarrit tip automatik. Dy të rinjtë që janë shpallur në kërkim akuzohen për plagosje të lehtë me dashje, kanosje dhe armëmbajtje pa leje.

**STRATI** Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Apartament Nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, i ndodhur në kat në pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Dajç, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 27.880 Euro.

**Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 24.10.2018.**

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**STRATI** Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-Regjistruar në Regjistrin hipotekor me Nr. 2035, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale me Nr. 2460, Apartament (3+1), Nr. 22, me sipërfaqe 136 m<sup>2</sup>, Seksioni Nr. 1, ndodhur në kat në katërt të Godinës së banimit dhe shërbimit 4-7-8 katëshe plus një kat parkim, Linzë, Komuna Dajç, Tiranë, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "Eurovini" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 52,584 Euro.

**Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 26.10.2018.**

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**Shoqëria përbarimorë JUSTITIA**

Shpall ankandin, faza parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna: Apartament me nr.pas.7/21+1-4, z.k.8360, vol.26, fq.204, me sip.138.40 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKU

Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 116.256 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dy qind e pesëdhjetë e gjashtë) EUR.

Ankand zhvillohet në datën 01.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adrese Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

## DOSJA "XHISIELA" ZBARDHET PËRGJIMI

Ballafaqimi/ Biseda në prokurori të vajzës që denoncoi Rexhep Rrajën: Nuk flas

# "U mbyll ajo punë. Edhe unë t'kam rraf njëherë", përgjimet e Xhisela Malokut

Rraja: Pistoletë s'kam përdor ndonjëherë ndaj m'vje inat

Vajza që denoncoi Rexhep Rrajën për dhunë dhe më pas e tërhoqi këtë denoncim, u vu nën një ballafaqim të përgjuar me ish-të dashurin e saj. Përgjimi ambiantal mes të rinjve është kryer në prokurorinë e Krujës, në datën 29 shtator, ndërsa dy të rinjtë janë regjistruar për rreth 2 orë e 30 minuta. Biseda mes të rinjve është regjistruar një ditë para arrestimit të djalit të deputetit të PS, fillimisht prokurorja Mirela Kapo ka pyetur në seanca të ndara dy protagonistët Xhisela Malokun dhe Rexhep Rrajën ndërsa më pas ka bërë ballafaqimin e tyre.

Në bisedë Xhisela thotë në prani të ish-të dashurit të saj se i ka thënë prokurores së nuk do të flasë për dhunën pasi nuk është në gjendje.

**Xhisela:** Ja për këtë, nuk mbaj mend thash, nuk du t'flas për tjetër njeri. A e ke dhënë më dijenin tënde a t'ka detyru kush? Jo, vetëm për këtë tha, për dhunën nuk do t'flas thash nuk jam në gjendje.

**Rraja:** Ku do t'flasësh?

**Xhisela:** N'Tiranë

**Rraja:** Po a e kena lanë që kena shpresat matanë, mos me u humb shpresat.

Ndërsa në vijim zbulohet se lidhja mes të rinjve duket se nuk e ka pëlqimin e deputetit socialist Rrahman Rraja, i cili i ka thënë djalit të tij se do e bëjë lanet të birin nëse shkon pas 25 vjeçares.

Edhe në këtë bisedë dy të rinjtë duket se janë treguar të kujdesshëm, pasi shpesh duket të flasin të rezervuar, apo edhe me kode me njeri-tjetrin.

Referuar bisedës, 25-vjeçarja insiston tek ish-të dashuri i saj Rexhep Rraja se para prokurores është shprehur se i qëndron deklarimit të dhënë me vullnetin e saj dhe se nuk e ka detyruar kush.

Si pjesë e bisedës mes tyre, Xhisela i thotë ish-të dashurit, se kanë ushtruar dhunë ndaj njeri-tjetrit disa herë, ndërsa i riu i thotë se pistoletë nuk ka përdorur ndonjëherë ndaj saj.



Xhisela Maloku

## RAMA "MBRON" VAJZEN



**Xhisela:** Jena rraf 100 herë sa jena rraf ne?! Edhe unë t'kam rraf një herë ta dish! Do t'denoncoosh?

**Rraja:** Pistoletë nuk kam përdor ndonjëherë ndaj m'vje inat.

**Procesverbal mbi veprimet e përgjimit ambiantal**

**(Mbi veprimet e përgjimit ambiantal)**

**Veprimet e përgjimit të bisedave filluan me vendimin e datës 29.09 2018, në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë, znj. Mirela Kapo.**

**Përgjimi u krye në datën 29.09.2018.**

**Regjistrimi i bisedave u filksua në shirit manjetik e CID.**

**Gjatë kësaj kohe u regjistruan bisedat e mëposhtme.**

Kryeministri Edi Rama, ka paralajmëruar një paketë antishpifje pas akuzave të opozitës mbi maxhorancën dhe atë vetë me denoncinin e dhunimit të Xhisela Malokut nga djali i deputetit të PS.

"Më vjen mirë që s'jam më i vetmi që them se vajzën e morën peng dhe e kthyen në mish për topat e kazarit politik e mediatic! Më mirë vonë se kurrë. Ndërkohë duhet gmontuar me fakte pjesa tjetër e këtij horrori mendjesh e gojesh të përdala. Dhe shumë shpejt një paketë antishpifje", shkruan Rama në "Facebook".

**LEGJENDA**

**A. Xhisela Maloku**  
**B. Rexhep Rraja**

**A.** Specifikisht ka thënë që dje ka qenë e mesume prej teje se t'kan ardhë kërcënime n'telefonatë kush jan ata t'ju q. .robt (E revoltur)

**B.** Ore deklaraten e kam dhënë kot!

**A.** Nuk du me ja ditë.

**B.** Po qetësohu ore.

**A.** S'du me u qetësu fare, nuk ta fal sa t'kem jetë, se e dëshova se ishte, e dëshova se ishte plan tjetër.

**B.** Mirë një sekond (E nderpret A-ja)

**A.** Jo jo e dëshova, sepse deklaraten e bone shume qartë edhe shumë bukur, e dëshova deri në momentin që nuk e mora në telefon! E dëshova deri në momentin që the hajde ke vil

**B.** O Zot m'fal ni sekond!

**A.** Tani deklaroje këtu para meje që ajo dje kur ka thënë kan ardhë kërcënime ka qenë atje, në momentin që t'ka thënë do t'bejë këtë pra ishte e mësuar prej teje.

**B.** Një sekond, a mbarove?

**A.** Po.

**B.** Te flas unë tashti?

**A.** Po, atë që të thash parë(E nderpret B-ja)

**B.** A të flas unë tani të lutem?

**A.** Nuk kam për të lënë.

**B.** He o Xhej! ma, pse bën kështu!?

**A.** Nuk kam pse të ngjoj!

**B.** O ti atë flas pak?

**A.** Nuk të ngjoj


**B.** A do flas tashti na prish ne o Xhi!?

**A.** Jo

**B.** Ooo mos bëj kështu

### PËRGJIMET

Biseda mes të rinjve është regjistruar një ditë para arrestimit të djalit të deputetit të PS, fillimisht prokurorja Mirela Kapo ka pyetur në seanca të ndara dy protagonistët Xhisela Malokun dhe Rexhep Rrajën ndërsa më pas ka bërë ballafaqimin e tyre. Në bisedë Xhisela thotë në prani të ish-të dashurit të saj se i ka thënë prokurores së nuk do të flasë për dhunën pasi nuk është në gjendje.



**A.** E ban m'qeftas se ty ma kanë dhanë fjalën, a ka dhanë fjalën dy burra mu ti vazhdon akoma m'qeftas, përdërisa ti ke arrite ke dhënë këtë deklarata ti vazhdon akoma.

**B.** Ore deklarata është 21 korrik

**A.** Nuk du me ja ditë siç t'jette urdhër yt ate mos u merr me mue ti u merrsh me qeftas.

**B.** Ore shqiptar, unë kam vendos kaq, jam i gatshëm jo sot, as nesër, një javë, dhjetë dite, një muaj, dy muaj të rri non stop me ty që ti ta shofësh a jam me të apo nuk jam.

**A.** Po do ta bësh!

**B.** Po, do t'rri non stop me ty do t'përgjigjem si të dush ti që a jam me të apo nuk jam.

**A.** Ke shkrujt atje m'ke bo kërcënime se kshu del.

**B.** Nuk të kam ofendur.

**A.** Ore më ke ofendur kurvë, prostitut!

**B.** Po pra.

**B.** Ore këtë muhabet e kena sqaru njëherë.

**A.** Ok në rregull se e sqaron prokurorja tashi.

**B.** Edhe anën e xhelozisë e për të gjitha këto me mu nuk kanë të bëjnë fare.

Pusho ore ma, se e kanë për presion, ashtu mos e caj trapin.

**A.** Jo or jo, i ka thënë nuk du t'flas atë që na ndodhi këtu se ashtu e kena lanë mos me folë ti për pjesën e dhunës fare. I qëndro deklarimit? I qëndron vetëm deklarimit që e kam dhënë me vullnetin tim, nuk m'ka detyru kush, për pjesën tjetër nuk i qëndroj.

**B.** Ku do ta japësh at deklaraten?

**A.** Nuk kam pse të ngjoj!

**B.** O ti atë flas pak?

**A.** Nuk të ngjoj

**B.** A do flas tashti na prish ne o Xhi!?

**A.** Jo

**B.** Ooo mos bëj kështu

tashti

**A.** Ti ke arritë ke bo gjitha planet!

**A.** Nuk e di, pse s'e more ne pyetje?

**B.** Po s'e mora pra se ishe me nerva siç je tashti! Edhe tani talle, babi im m'thanna q.se ti i shko mbrapa, unë të bëj lanet. Edhe ti (E nderpret A-ja)

**A.** Ti i ke shku deri mbramë mbrapa! Edhe unë nuk du me ja ditë, ajo aty ka ardh e msume prej teje.

**B.** Ku i shkova mbrapa ore!

**A.** Ajo aty ka ardhë e m'sume prej teje!

**B.** Ore një sekond!

**B.** Ngjo një sekond!

**A.** Po te ngjoj o po te ngjoj!

**B.** Mos bërtit (Debatojnë të dy njëherësh) Ore e ke leshu ti deklaraten!?

**A.** Jo.

**B.** Ke qenë aty ore

**A.** Se kam lexu them unë. Ke qenë aty

**A.** Nuk e kam lexu, nuk kam qenë aty ke qenë vetëm!

**B.** Mirë pra!

**A.** Kam faj se kam qenë aty.

**B.** Tashi një sekond.

**A.** Nuk ka!

**B.** Me fal një sekonde, të flas, përdërisa i përket...

**A.** Nuk du me ja dite.

**B.** Rasti i dëshëm...

**A.** Kur isha me ata, kur isha me ata?

**B.** Përsa i perket rastit te dëshëm ta kanë dhënë fjalën dy burra, prit.





Faksimil e pergjimeve

Gjykata e Apelit mban në burg djalin e deputetit të PS, Rrahman Rraja

# Rraja mbetet në qeli, debate në gjyq mes avokatit e gjyqtarëve

Mbrojtja: Shkelje e të drejtave të njeriut

Në Shqipëri, Gjykata e Apelit konfirmoi të mërkurën masën e 'arrestit me burg' për Rexhep Rrajën, djalin e deputetit socialist Rrahman Rraja, i vënë në pranga pasi akuzohet për përndjekjen e ish-të dashurës së tij Xhisiela Maloku. "Zëri i Amerikës" shkroi se avokati kërkoi lirinë e të riut, duke pretenduar se po shkeleshin të drejtat e njeriut, ndërsa vetë Maloku ishte në sallën e gjyqit për të kërkuar lirinë e të riut.

Vajza 25-vjeçare, bëri kallëzim ndaj ish-të dashurit Rraja në muajin korrik, duke e tërhequr më pas. Megjithatë çështja i kaloi prokurorisë. Maloku i ishte drejtuar disa herë policisë, duke akuzuar Rrajën, me të cilin kishte pasur një marrëdhënie të gjatë dashurie, për kërcënime dhe dhunë ndaj saj. Në deklarimet e saj ajo ka pranuar se është detyruar të tërhiqet për shkak të frikës që kishte nga hakmarrja e djalit.

Episodi që çoi në arrestimin e të riut Rraja, lidhet me dhunën që ai kishte ushtruar ndaj Malokut në një dhomë hoteli. Por në dy intervista televizive, vajza mohoi që ndaj saj të ishte ushtruar dhunë, duke deklaruar se ajo e kishte bërë gjithçka nga xhelozia dhe se kallëzimi i saj kishte qenë i rremë. Edhe gjatë seancës së djeshme, ka pasur debate mes avokatit të Rrajës dhe trupës gjyqesore, e cila i ka mëshuar faktit se vajza ka bërë disa herë denoncime në polici, pranë oficerëve të ndryshëm, duke dhënë megjithatë të njëjtat deklarime për dhunë nga ana e Rrajës.

Nga ana tjetër, edhe ekspertiza mjeko-ligjore e realizuar pas denoncimit të Malokut në polici, konfirmoi shenjat e dhunës në trupin e vajzës. Është pikërisht ekspertiza mjeko-ligjore ajo që ka mbajtur në pranga Rexhep Rrajën,



Rexhep Rraja, në gjykatë

## Emiljano Nuhu: Më thanë "do të zhdukim, hiq dorë"

Më 30 korrik 2018, oficeri i policisë Emiljano Nuhu kallëzoi në polici se u kërcënua nga Redjan dhe Ramazan Rraja, nipër të deputetit të PS Rrahman Rraja. Emiljano Nuhu dha detaje në polici në lidhje me bisedën e bërë në lokalim 'Rich Mond' ku ndodhi takimi mes tyre.

Oficeri Nuhu pretendon se kushërinjtë Rraja e kanë kërcënuar me jetë duke i thënë se nëse nuk heq dorë nga hetimi i çështjes së Xhisielës do ta zhdukim brenda 24 orëve.

Ish-oficeri Emiljano



Nuhu ndodhet në një nga vendet e BE-së pas intervistës së tij, ku shprehej se i ishte vënë pistoletë në kokë

në sy të deputetit Taulant Balla dhe Rrahman Rraja për çështjen 'Xhisiela', ku ishte i përfshirë djali i Rrajës. Djali i deputetit socialist Rrahman Rraja akuzohet për dhunimin e ish-të dashurës Xhisiela Maloku. Rexhep Rraja u arrestua pas urdhrit të gjykatës së Krutës, e cila ka dhënë 'arrest me burg' në mungesë për të riun e akuzuar për dhunimin e Xhisiela Malokut. Vendimi i gjykatës vjen edhe pas administrimit të aktit të ekspertizës për të renë e dhunuar dhe e torturuar nga Rraja.

sikundër dhe një përgjim i kryer më 29 shtator, gjatë ballafaqimit mes dy të rinjve në prokurori, ku sërisht Rraja ka kërcënuar vajzën.

### FLET XHISELA MALOKU

Pasi ish-i dashuri i saj Rexhep Rraja u lërisht në burg, nga jashtë Gjykatës së Apelit Xhisiela Maloku ka bërë 'avokatin' e tij mbrojtës, pavarësisht se ish-të denoncimi i saj për përnd-

jekje që e çoi pas hekurave.

Në një prononcim për gazetaret 25-vjeçarja tha se kishte shkuar në gjykatë për ta mbështetur ish-të dashurin, pasi ishte i pafajshëm. Po ashtu Xhisiela tha se me Rrajan kishte kontakte dhe se kishin marrëdhënie të mirë shoqërore.

"Erdha për ta mbështetur, për arsye të trafikut arrita vonë. Kjo bëri që mos të isha në gjykatë. Në seancën

tjetër do e mbështes. Nuk jam viktimë. S'kam presion. Këtë e kam bërë edhe deklarata notoriale. Ato që kam thënë në media janë të vërteta, dhe duhet të më besoni. Oficeri i policisë është në azil. Skam informacione të tjera. Kam kontaktuar me të, kam marrëdhënie të mira. Kemi marrëdhënie shoqërore. Erdha për ta mbështetur në gjykatë", tha Xhisiela.

## Maloku

**DEKLARATA PAS GJYQIT**

"Nuk jam viktimë. S'kam presion. Këtë e kam bërë edhe deklarata notoriale. Ato që kam thënë në media janë të vërteta, dhe duhet të më besoni. Erdha për ta mbështetur, për arsye të trafikut arrita vonë. Kjo bëri që mos të isha në gjykatë. Në seancën tjetër do e mbështes", -tha Maloku.

- A.** Nuk e di, nuk e mbaj mend.
- A.** Ku di gjo unë, jena rraf njëqind herë, sa jena rrafë ne? Edhe unë t'kam rrafë njëherë ta dish. Do t'denoncosh?
- B.** Pistolet nuk kam përdorunaj herë, prandaj më vjen inate!
- A.** Kam me e q... (Qesh) A t'shkoj ta marr njëherë aaa?! A je tu e marr me e pru këtu? (Qesh)
- B.** Se ashtu te thote vete ajo, te lajmerova une? Siç nuk e njoh, une i them nuk jap.
- A.** Ai tha lidhur me Instagramin.
- B.** Si?
- A.** I bie me qite Instagramin.
- B.** Po rri or ma pash Zotin.
- A.** Je kurvë kam për të thanë!
- B.** Po hidhi poshtë qeto mut deklarata Fate, Sue-la e ca janë!
- A.** Erdh sot këtu Suada u ballafaqum.
- B.** Po.
- A.** U mbyll ajo punë, iku, fleje menjëherë.

- B.** Atëherë mos lëvizim prej këtu.
  - A.** Jo jo pra.
  - B.** Kush tha?
  - A.** Do ikim pastaj të hamë nai gja se vdiqaj.
  - B.** Po a tu prite Indriti pra, do ikim me hangër bukë!
  - A.** Do vijsh ti?
  - B.** Po vij, vij unë. Prandaj po t'them mos prish punë.
  - A.** Jo mor s'prish punë. Po ti m'hangre, m'çmende. I kam hudhë fare, m'kanë marrë ne pyetje disa herë.
  - B.** Mirë unë du ta shikoj, ta lexoj.
  - A.** Po i kam hedhe mor qafsha t'gjithë.
  - B.** Po mirë mo ta lexojmë kot.
  - A.** Siç thash tashi nuk flas për ju, nuk flas sepse mos fol, nuk jam në gjendje me folë a e kupton ti se unë jam çmend.
- Në këtë moment ndërhyu oficeri policisë gjyqësore e veprimi ndërprirte

**OFICERI I POLICISË GJYQËSORE**  
**Rexhep DERVENI e**  
**Elsen HOXHA**

**SHPALLJE ANKANDI**  
Datë 24.10.2018, Ora 16:30

Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Sipall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të dorëzuarit Baftar Akush Murto: "Trual" në Ndërkeshë me sipërfaqe truall 300 m2 dhe ndërtesë 81 m2, regjistruar në regjistrin hipotekor me volumn nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.

Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 1 008 000 (një milion e tetë mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Datë 23.10.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Sipall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Agron Shelqet Burhan dhe dorëzuarit Haxhië Shelqet Burhan: "Apartment + Trual" me sipërfaqe 62 m2, nr. pasurie 14/301, zona kadastrale 3574, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 2561 datë 07.10.1994, me adresë: Laga "15 Shator", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Tëpelëni.

Çmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 806 400 (tetëqind e gjashtë mijë e katërqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Sabri Laçi: Nxitoni për regjistrimet në master, 20 tetori, afati i fundit

# Filologjiku plotëson 95.5% të kuotave në nivelin bachelor

*Dekani: Mundësi edhe në raundin e tretë*



Voltiza Duro

**E**dhe pse viti i ri akademik 2018-2019 ka nisur, maturantët që ende nuk kanë arritur të shpallen fitues në një prej programeve të studimit, kanë një mundësi të fundit. Në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës, në dy raundet e para të aplikimeve janë plotësuar 95.5% e kuotave të përcaktuara. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", dekani i këtij fakulteti, Sabri Laçi tregon se pjesa e mbetur e kuotave boshe do të plotësohet gjatë raundit të tretë të regjistrimeve. Sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit, këtë vit akademik, programet e mësuesisë kanë pranuar vetëm maturantët me një mesatare mbi notën 7, e ky fakultet ka 3 programe të tilla, respektivisht në Histori, Gjeografi e Gjuhë-Letërsi. Fakulteti i Histori-Filologjisë edhe këtë vit do të shpërndajë bursa merite për studentët ekselentë, por edhe bursa nevojë për ata që janë në vështirësi ekonomike apo pjesë të kategorive të veçanta. Ndërkohë dekani i bën thirrje të interesuarve që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në master të nxitonjë, pasi 20 tetori është afati i fundit i aplikimeve.

**Sa është numri i studentëve që janë regjistruar në Fakultetin e Histori-Filologjisë për vitin e ri akademik 2018-2019?**

Për vitin e ri akademik 2018-2019, në 5 programet e nivelit bachelor në Fakultetin e Histori-Filologjisë në dy raundet e para janë plotësuar 95.5% e kuotave. Kjo do të thotë se ka një ecuri me të vërtetë shumë të mirë dhe jemi optimistë se pjesa e mbetur e kuotave boshe do të plotësohet gjatë raundit të



Dekani i Fakultetit të Histori-Filologjisë duke folur për "GSH"

95.5%

### E KUOTAVE, TË PLOTËSUARA

"Për vitin e ri akademik 2018-2019, në 5 programet e nivelit bachelor në Fakultetin e Histori-Filologjisë në dy raundet e para janë plotësuar 95.5% e kuotave. Kjo do të thotë se ka një ecuri me të vërtetë shumë të mirë dhe jemi optimistë se pjesa e mbetur e kuotave boshe do të plotësohet gjatë raundit të tretë", thotë dekani.

trëtë.

**Përkatesisht sa përqind e kuotave janë plotësuar në 5 degët e nivelit Bachelor në këtë fakultet?**

Vlen të theksoj se në programin Gjuhë-Letërsi janë plotësuar 98% e kuotave; në Gazetari janë plotësuar 88% e vendeve të vëna në dispozicion; ndërsa në programin Gjeografi janë plotësuar 96% e kuotave. Ndërkohë

në degën Histori janë plotësuar 98% e kuotave, në një kohë që në Arkeologji janë zënë 96% e vendeve të vëna në dispozicion për studentët.

**A ka pasur kërkesa për programet e studimit që ofron ky fakultet gjatë raundit të tretë?**

Normalisht që ka pasur kërkesa. Sekretaria mësimore po mban dosjet e të gjithë

aplikantëve që dëshirojnë të bëhen pjesë e fakultetit dhe në mbylljen e fazës së pranimit të aplikimeve, do të bëhet shqyrtimi i tyre bazuar në kriteret e përcaktuara nga komisionet e posaçme pranë çdo departamenti. Nisur nga nota mesatare e secilit aplikant, do të pranohen ata që renditen të parët pasi kanë ngelur shumë pak vende.

**Fakulteti i Histori-Filologjisë ka tri programe studimi mësuesie që kërkojnë si kriter kryesor mesataren mbi 7 për këtë vit të ri akademik. Sa ka ndikuar kjo në rritjen e nivelit të studentëve të pranuar?**

Në këtë fakultet ka tri pro-

### PROGRAMET MASTER

"Masteri ka filluar regjistrimet që prej 1 tetorit e këto regjistrime do të vazhdojnë deri në 20 tetor. Deri më tani ecuria është pozitive e jemi shumë të kënaqur pasi të 12-të programet në master (4 mastera profesionalë dhe 8 mastera shkencorë) janë drejt plotësimit të kuotave të fundit. Të gjitha degët janë të kërkuara pasi ne nuk kemi pasur tendencën të hapim shumë programe, por të ofrojmë ato degë që kanë mundësitë më të mëdha për punësim në të ardhmen. Këtë vit kemi një master të ri profesional të hapur në departamentin e Gjeografisë, përkatesisht në degën Sistemi i Informacionit Gjeografik i Aplikuar që është në përputhje me kërkesat e tregut e kështu studentët do të dalin specializistë në të ardhmen. Ky program është përgatitur në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë e është një prurje krejt e re.

bursa. Këto bursa do të jepen sipas kriterëve të përcaktuara në ligj për studentët që vijnë nga familje me të ardhura jo të mira si dhe për studentët që janë pjesë e kategorive të veçanta. Por vlen të theksoj që bursa do të jepen edhe për studentët ekselentë, të cilët do të përfitojnë mbështetje financiare.

**Kur është afati i fundit i aplikimeve për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të studiojnë në një prej programeve të nivelit të dytë master në këtë fakultet?**

Masteri ka filluar regjistrimet që prej 1 tetorit e këto regjistrime do të vazhdojnë deri në 20 tetor. Deri më tani ecuria është pozitive e jemi shumë të kënaqur pasi të 12-të programet në master (4 mastera profesionalë dhe 8 mastera shkencorë) janë drejt plotësimit të kuotave të fundit. Të gjitha degët janë të kërkuara pasi ne nuk kemi pasur tendencën të hapim shumë programe, por të ofrojmë ato degë që kanë mundësitë më të mëdha për punësim në të ardhmen. Këtë vit kemi një master të ri profesional të hapur në departamentin e Gjeografisë, përkatesisht në degën Sistemi i Informacionit Gjeografik i Aplikuar që është në përputhje me kërkesat e tregut e kështu studentët do të dalin specializistë në të ardhmen. Ky program është përgatitur në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë e është një prurje krejt e re.

**A ka laboratorë të përshatshëm në Fakultetin e Histori-Filologjisë ku studentët të mund të kryejnë praktikat mësimore?**

Normalisht që para se të hapet një program i ri institucioni mendon që të krijojë të gjitha kushtet për një mësimdhënie optimale. Ne kemi nguritur edhe një laborator të ri për studentët e të gjitha departamentet kanë një laborator. Më tej vijin praktikat në terren dhe praktikat profesionale. Kemi një ekip profesional të angazhuar për formimin e mjetshëm të studentëve.

**Sa përqind e studentëve arrijnë të punësohen pas diplomimit?**

Nuk them dot një shifër të saktë. Por mund të them se studentët në këtë fakultet vijnë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë e pasi diplomohen dëshirojnë të qëndrojnë të gjithë në Tiranë. Por deri më tani mund të them se shumë prej studentëve tanë kanë filluar punë në profesionin e tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e suportit vjetor të produktit Fire - Eye"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,800,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqjen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC  
Përshtkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e suportit vjetor të produktit "Fire - Eye"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 12 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**NJOFTIM**

**Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k.** propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORCA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impianitit të Trajtitit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjjes Publike për të bërë publike rezultatat e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjesa Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** në sallën e takimeve tek **"Grand Hotel Korça"**



Këngëtari i njohur i repit u prangos nga policia në një hotel në zonën e Linzës në periferi të Tiranës

# Armë dhe kokainë, arrestohet Stresi

*Policia: Anëtar i një grupi kriminal. Shoqërohet edhe 20-vjeçarja*

**K**ëngëtari Arkimed Lushaj, i njohur si "Stresi" është arrestuar nga efektivat e policisë të Tiranës i akuzuar për armëmbajtje pa leje.

Menjëherë pas ngjarjes, policia e Shtetit ka reaguar me anë të një njoftimi për shtyp për arrestimin e reperit të njohur Arkimed Lushaj i njohur me emrin e artit, "Stresi".

Në njoftim thuhet: "Forca e Ligjit në veprim vë në pranga një nga anëtarët e një grupi kriminal që operon në Tiranë në lidhje me aktivitetin e kundërligjshëm me tendencë "Trafikim narkotikësh" dhe "Krimeve kundër personit".

Njësi Hetimore e Task Forcës Speciale Vendore Tiranë në Departamentin e Policisë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale të Policisë së Shtetit bëri kapjen dhe ndalimin e shtetasit: Arkimed Lushaj, 31 vjeç, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë.

Gjykata pranë Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr 1972 datë 17.10.2018, ka caktuar masën e sigurisë "arrest me burg" në lidhje me veprën penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarakë", parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal.

Ndalimi i këtij shtetasit u bë pas një hetimi disa mujor në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me metoda speciale të hetimit që janë kryer në

**NJOFTIMI**  
Njësi Hetimore e Task Forcës Speciale Vendore Tiranë në Departamentin e Policisë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale të Policisë së Shtetit bëri kapjen dhe ndalimin e shtetasit: Arkimed Lushaj, 31 vjeç, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë.



Këngëtari Arkimed Lushaj (Stresi)

**ARRESTIMI**  
Gjatë arrestimit të shtetasit Arkimed Lushaj në ambientet e një hoteli të ndodhur në vendin e quajtur Linzë gjatë kontrollit të ushtruar i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një sasi e vogël lënde narkotike e dyshuar kokainë, një armë zjarri pistoletë e tipit "Pietro Beretta", si dhe 12 fishekë të modelit 7.65 mm.

funkcion të një grupi kriminal që operon në Tiranë në lidhje me aktivitetin e kundërligjshëm me tendencë "Trafikim narkotikësh" dhe "Krimeve kundër personit".

Gjatë arrestimit këtij shtetasi në ambientet e një hoteli të ndodhur në vendin e quajtur Linzë gjatë kontrollit të ushtruar i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një sasi e vogël lënde narkotike e dyshuar kokainë, një armë zjarri pistoletë e tipit "Pietro Beretta", si dhe 12 fishekë të modelit 7.65 mm.

Nga veprimet hetimore të kryera në lidhje me ngjarjen e mësipërme filloi procedimi penal në gjendje të lirë në lidhje me veprën penale të "Moskallëzimit të krimit", parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal ndaj shtetas P.

Ç., 20 vjeçe, banuese në Tiranë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore në lidhje me veprat penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhim të armëve shpërthyes dhe të municioneve" dhe "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 278/1 dhe 283 i Kodit Penal mbyllet njoftimi i policisë.

**ÇFARË JU GJETË STRESIT**

Gjatë kontrollit të ushtruar i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një sasi e vogël lënde narkotike e dyshuar kokainë, një armë zjarri pistoletë e tipit "Pietro Beretta", si dhe 12 fishekë të modelit 7.65 mm.

**Kreu i Grupit të PS e quajti pjesë të bandës së Berishës**

## Sali Lushaj, babai i këngëtarit paditi për shpifje Taulant Ballën

Sali Lushaj ka paditur në Gjykatën e Tiranës deputetin e Partisë Socialiste, Taulant Balla. BalkanWeb shkroi përdje se "gjykata e Tiranës ka depozituar padinë e Lushajt, babai i këngëtarit të njohur të repit, Stresi".

Ky veprim vjen pas deklarimit të kreut të Grupit Parlamentar të PS-së Balla, i cili tha se Lushaj ishte pjesë e 'bandës së Berishës'. BalkanWeb ka mësuar se Sali Lushaj kërkon



dy milionë lekë të reja dëmshpërblim nga Balla.

Në një video të publikuar për çështjen 'Babalja' deputeti i PD-së Ervin Saliqjani

paraqiti sipas tij bisedën mes Sali Lushajt dhe Fredi Alizotit, bisedë në të cilën implikohej emri i Ballës. Kaq mjaftoi që socialisti të 'shpërthente' në akuzën ndaj Lushajt.

Kujtojmë se Balla ka vënë në qendër të sulmeve të tij Lushajn edhe herë të tjera, kur ky i fundit ishte pjesë e një proteste të organizuar nga PD më dhjetor të vitit të kaluar, duke e cilësuar atë si njeri të besuar të Berishës.

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

ÇIFTI I SHOW BIZZIT QË NUK PRANOI KURRË SE ISHIN TË DASHURUAR

# S'ka fejesë! Sardi ndahet nga e dashura, shkak tradhtia

*Ja e vërteta që "u mbulua" nga kontrata e punës së balerinës*

Egla Xhemali

Ai asnjëherë nuk e kishte pranuar publikisht lidhjen e dashurisë, por të gjithë miqtë e rrethit të tij e dinin se balerina e njohur e Tv Klan, Jora Hodo, dhe Dj Sardi janë tre vjet në një romancë. Dashuria që kishte lindur në korridoret e 'Dance with me' vijoi edhe jashtë skenës së baletit. Jo rrallë herë Sardi dha sinjale nga llogaritë e tij sociale, me ndonjë foto e me mesazhe të koduara që ishte në një romancë dhe pse donte ta mbante raportin jashtë medias rozë. Burime për "Gazeta shqiptare" pohojnë se çifti ka qenë në hedhjen e një hapi tepër të rëndësishëm, të cilin Sardi e ka prishur. Mësohet se ata kanë qenë gati për të zyrtarizuar lidhjen e tyre në fejesë, por Sardi e ka tradhtuar bukurshen. Akoma nuk dihet shkak i kësaj tradhtie, pse Sardi preferoi të zgjidhte këtë lloj mënyre për t'u shkëputur përfundimisht nga e dashura e tij. Dj më i dashur i tregut muzikor para një viti ka qenë i ftuar te "Rudina", e cila i bëri pyetje për raportin e dashurisë që ai ndodhej, por Sardi e anashkaloi. Duke përgjithësuar dashurinë, ai tha se është gjithmonë i dashuruar: "Jeta është shumë e shkurtër për të mos dashuruar... ", - dhe shtoi se të dashurosh është një ndjenjë pozitive, edhe pse e përgjithëson ndjenjën duke thënë "duhet të dashurosh ?do gjë". Por, historia bëhet edhe më interesante nga mohimet e vazhdueshme që Sardi ka bërë lidhur me një foto të postuar të Jorës, ku sërish refuzoi të pranonte se ishte në një



lidhje me të: "Nuk është e dashura ime, është një mikeshë ime shumë e ngushtë..." Kudo në media po qarkullon lajmi se Sardi dhe Jora i kanë dhënë fund lidhjes së dashurisë e se shkak i

vërtetë sipas njerëzve të afërt të çiftit, është një kontratë profesionale e Jorës në Amerikën Latine. Kjo mund të jetë një prej arsyeve, por nuk kanë qenë të pakta rastet kur mjaft çifte të show bi-

zzit kanë arritur të mbajnë lidhje në distancë. Nuk është e besueshme kjo hipotezë që personat e tyre të besuar hedhin për të "mbuluar" të vërtetën e historisë së ndarjes së miqve të tyre. Deri më tani

lajmi nuk është konfirmuar nga çifti. Kujtojmë se kjo nuk është lidhja e vetme e show bizzit që merr fund në këtë lloj mënyre. Seldi Qalliu dhe Mimoza Shkodra që ishin gati të mbanin ceremoninë e mar-

tesës u ndanë paqësisht me njëri-tjetrin pa i kushtuar dhe aq rëndësi atij momenti. Shpresojmë që ndarje të tilla të bujshme si kjo e Dj Sardi dhe e çiftit tjetër të estradës shqiptare të mos ketë më.





## Vajza e Sabianit "ndez" rrjetin me foto seksi

Vajza e këngëtarit të njohur Sabian është vënë shpesh në qendër të vëmendjes nga mediat rozë për shkak të pamjes së saj dhe fotove provokuese që poston. Keisi ngjall gjithnjë polemika tek përdoruesit e rrjeteve sociale për shkak të ekspozimit të linjave të saj trupore. Edhe këtë radhë ajo nuk ka zhgënjyer, pasi ka postuar një foto nga vera ku duket e veshur me bikini shumë të vogla. "Missing summer", shkruan Keisi ndërkohë që sytë e të gjithëve, sidomos të djemve, fokusohen tek format e saj.



## Ndarja që nuk la gjumë! Mimoza Shkodra më e lumtur se kurrë

Këngëtarja Mimoza Shkodra vazhdimisht po shfaqet duke qeshur. Duket se bukuroshes nuk i ka lënë shenjë ndarja nga ish-i fejuari i saj, Seldi. Të paktën kështu lë ajo të kuptohet, me imazhet, që publikon ku shihet gjithmonë e lumtur dhe duke qeshur. Mimoza nuk ka bërë ende asnjë koment për ndarjen dhe duket se do të vazhdojë të mos merret me këtë temë më. Për shumë kohë ata qenë çifti më i pëlqyer i show bizzit megjithatë këngëtarët janë ndarë paqesisht, pa pasur përplasje me njëri-tjetrin.



## Enca foto të nxehta nga shtrati, zbuloni si duket këngëtarja

Enca Haxhia ndodhet aktualisht në Paris. Këtë herë ajo ka publikuar një foto në rrjete sociale ku tregon se sapa është zgjuar nga gjumi. Edhe këtë herë këngëtarja nuk ka nguruar të ekspozojë gjoksin e saj bombastik, ndërkohë që ka qenë e veshur me një palë reçipeta të zeza. Ajo është përfolur mjaft për look-un e saj megjithëse duket se fjalët nuk i bëjnë përshtypje. Haxhia aktualisht po shijon suksesin e hitit të saj më të fundit "Kujt po i han", që mesa duket u dedikohet të gjithë atyre që e kanë inat këngëtarën.



## Xhensila Myrtezaj pa make-up, këngëtarja i mahniti të gjithë

Ajo është një nga këngëtarët më të bukura të show bizzit shqiptar. E kemi fjalën për Xhensila Myrtezajn. Këngëtarja ka publikuar në rrjete sociale një foto ku shfaqet tërësisht pa make-up. Në këtë foto-selfie e shohim fare të thjeshtë. Xhensila para tre muajsh më parë ka sjellë në jetë fëmijën e saj të parë, vogëlushen Ajka. Nuk dihet se kur këngëtarja do t'i rikthehet muzikës me projekte të reja muzikore.



Integrimi në NATO, nisin sot formalisht bisedimet me Maqedoninë

# Përplasje në qeveri, dorëhiqet ministri i Jashtëm i Greqisë

## Tsipras merr vetë edhe postin e ministrit Kotzias

**E**dhe pse nuk është miratuar përfundi misht marrëveshja e Prespës, zhvillime të papritura po ndodhin në palën greke. Pikërisht ditën e djeshme, ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias ka dhënë dorëheqjen nga posti i tij. Lajmi është bërë i ditur nga mediat greke ku sipas raportimeve paraprake, motivi mendohet të ketë lidhje me pakënaqësi brenda koalicionit qeverisës. Burimet e së përditshmes greke "Kathimerini" flasin për një përplasje mes Kotzias dhe ministrit të Mbrojtjes, Panos Kamenos që kanë ndodhur ditën e martë në mbledhjen e qeverisë. Sipas kolegëve të ministrit të Jashtëm që kanë folur në kushte anonimati për "Kathimerini", "Kotzias ka qenë tmerrësisht i prekur nga sulmet e Panos Kamenos, që e akuzon për keqmenaxhim të fondeve të Ministrisë së Jashtme, e cilëson njeri të Soros dhe për sulme të tjera me karakter të ngjashëm". Debatu me tyre nisi fillimisht për marrëveshjen e Prespës, që ka të bëjë me ndryshimin e emrit të Maqedonisë. Në mbledhjen që u zhvillua ditën e martë të kabinetit qeveritar të Greqisë, ministri Kotzias i kërkoi kryeministrit Tsipras që të mbikëqyrë fondet sekrete të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të ministrive të tjera. Sipas "Kathimerini", Kotzias kërkoi nga Tsipras gjithashtu që të zbatojë të njëjtin ligj për të gjitha ministrat që kanë në bux-

### ZËDHËNËSI I QEVERISË GREKE

"Kush është i mërztur, le të zbrësë nga 'treni' i qeverisë. Ne kemi destinacion dhe drejtim të qartë. Kush nuk dëshiron destinacionin, të zbrësë nga treni i qeverisë", ka thënë zëdhënësi i qeverisë greke.



Ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias dhe kryeministri Alexis Tsipras

### MEDIAT GREKE

"Kotzias ka qenë tmerrësisht i prekur nga sulmet e Panos Kamenos, që e akuzon për keqmenaxhim të fondeve të Ministrisë së Jashtme, e cilëson njeri të Soros, dhe për sulme të tjera me karakter të ngjashëm".

hetin e tyre një "fond sekret", ligj që aktualisht aplikohet vetëm për Ministrinë e Jashtme. Një nga ministrat që kanë "fonde sekrete" është Departamenti i Mbrojtjes. Në propozimin që Kotzias bëri të martën në mbledhjen e qeverisë, pati fyerje joetike mes ministrave Kamenos-Kotzias, raporton shtypi grek. Për shkak të përplasjeve që ndodhën në mbledhjen e kabinetit qeveritar, ministri Kotzias dha dje dorëheqjen dhe sipas mediave të Athinës, ai

është i zhgënjyer nga kryeministri Alexis Tsipras, që nuk e mbrojti nga sulmet e ministrit Kamenos. Ky i fundit është kreu i partisë aleate në koalicionin qeverisës. Këtë pretendim të tij e konfirmon qartë edhe zëdhënësi i qeverisë greke, që reagoi duke thënë se "kush është i mërztur, le të zbrësë nga treni i qeverisë. Ne kemi destinacion dhe drejtim të qartë. Kush nuk dëshiron destinacionin, të zbrësë nga treni i qeverisë". Ndërkohë, kryeministri i

Alexis Tsipras ka pranuar dorëheqjen e Kotzias dhe ka marrë vetë edhe postin e ministrit të Jashtëm deri në mbylljen e marrëveshjes së Prespës, ku përfshihet çështja e emrit me Maqedoninë. Nga ana tjetër, NATO do të nisë sot formalisht bisedimet e anëtarësimit me Maqedoninë. Ky veprim vjen edhe pse referendum i 30 shtatorit për ndryshimin e emrit të Maqedonisë, kusht i vënë nga Greqia për të mos e bllokuar rrugën e Shkupit drejt Aleancës, nuk e

ka kaluar pragun prej 50% për të qenë i vlefshëm. Megjithatë, mbi 90% e atyre që kanë dalë në referendum kanë votuar për ndryshimin e emrit në Maqedoni e Veriut. Këtë marrëveshje, Maqedonia dhe Greqia e kanë arritur në qershor, në përpjekje për t'i dhënë fund kontestit 27-vjeçar. Qysh në vitin 1991, kur Maqedonia ka shpallur pavarësinë, Greqia i ka shaktuar bllokada diplomatike, duke thënë se me këtë emër, fqinj i saj mund të ketë pretendime terri-

oriale ndaj një territori grek, që po ashtu quhet Maqedoni. Megjithatë, NATO e bëri të qartë se marrëveshja për emrin duhet të ratifikohet edhe nga Athina, edhe nga Shkupi, në mënyrë që Maqedonia të bëhet anëtar i 30-të i Aleancës. Bisedimet e pranimit zakonisht zgjasin rreth tre muaj përpara se të nënshkruhet një protokoll i pranimit. Më pas protokollin duhet të ratifikohet nga të gjithë anëtarët e tjerë të NATO-s, proces ky që zgjat rreth një vit.

## Ish-ambasadorja amerikane: Misioni i OKB-së s'ka ndryshuar

### Dha dorëheqjen, Haley kërkoi tërheqjen e UNMIK-ut nga Kosova

**I**sh-ambasadorja amerikane në OKB, Nikki Haley, në të njëjtën ditë që njoftoi tërheqjen nga pozita e saj, i dërgoi një letër sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres, në të cilën kërkonte tërheqjen e UNMIK-ut nga Kosova. Letra u dërgua më 9 tetor, në të njëjtën ditë kur Haley bëri me dije se po largohej nga posti i përfundimtar në Shteteve të Bashkuara në Kombet e Bashkuara. Haley deklaroi në letër në saj se mbështet përpjekjet e sekretarit të përgjithshëm dhe OKB-së në ruajtjen e paqes në botë. "Misioni paqeruajtës i OKB-së është të kryejë punë të mirë në vendin ku ndodhet dhe të jetë në gjendje t'i japë fund konfliktit dhe të ngrejë procese politike e demokratike. Për shumë vite, misioni i OKB-së në Kosovë ka dhënë

#### LETRA E ISH-AMBASADORES AMERIKANE NË OKB

"Misioni paqeruajtës i OKB-së është të kryejë punë të mirë në vendin ku ndodhet dhe të jetë në gjendje t'i japë fund konfliktit, të ngrejë procese politike e demokratike. Për shumë vite, misioni i OKB-së në Kosovë ka dhënë një shembull të një misioni të suksesshëm që zgjidh një konflikt kompleks. Suksesi i Kosovës i shënuar në dhjetëvjetorin e shpalljes së pavarësisë duhet të jetë shkak për krenrim dhe një simbol i kontributit të madh të bërë nga OKB-ja në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Evropë", shkruan Haley në letër.

një shembull të suksesshëm, që zgjidh një konflikt kompleks. Suksesi i Kosovës, i shënuar në dhjetëvjetorin e shpall-

jes së pavarësisë duhet të jetë shkak për krenrim dhe një simbol i kontributit të madh të bërë nga OKB-ja në ruajtjen

e paqes dhe stabilitetit në Evropë", shkruan ajo në letër. "Për fat të keq, vazhdon Haley - misioni i OKB-së në Kosovë nuk ka ndryshuar, me gjithë progresin e arritur dhe deklarata disa herë të përsëritura të anëtarëve të përherëshëm të Këshillit të Sigurimit se UNMIK-u e ka përmbytur që vjet mandatin". Me tujtje, në letër theksohet se, "pa shqyrtim të duhur të mandatit të misionit të UNMIK-ut, politikat e jashtme dhe palët me interes të dëmshëm do të vazhdojnë të mbajnë peng burimet e vlefshme të OKB-së. Kjo është arsyeja pse unë kërkoi nga sekretari i përgjithshëm që të ndikojë me autoritetin e tij dhe të fillojë



Ish-ambasadorja amerikane në OKB, Nikki Haley

krijimin e një rrugëdaljeje për UNMIK-un. Kur të ndërmerren këto hapa, kjo do t'i lejojë Këshillit të Sigurimit që t'i qaset dhe vlerësojë rolin e misionit të OKB-së në Kosovë, siç edhe ndodh kur bëhet fjalë për misionet e tjera të paqes", tha Haley. "Duke ndërmarrë këto hapa, ne do të avancojmë normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës dhe qëllimin e tyre të përbashkët,

integrimit në BE. Gjithashtu, jam e bindur se strategjia e vlerësimit dhe daljes së UNMIK-ut do të ruajë integritetin e përpjekjeve tuaja të mëdha në zbatimin e reformave", përfundon letërën Haley, jam e shpresën se do të vazhdojë bashkëpunimin me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së për mbështetjen e paqes në Kosovë, por edhe në mbarë botën.



## Drejtori rajonal i ICRC: Thirrje të lirojnë 2 të tjerët

# Mbahej peng prej 8 muajsh, ekzekutohet punonjësja në Nigeri

Pas një periudhe të gjatë të mbajtur peng, ditën e djeshme, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) në Abuja, Nigeri, u informua se Hauwa Mohammed Liman është vrarë nga rrëmbyesit e saj në një akt të neveritshëm mizor. Ajo është punonjësja e dytë shëndetësore e rrëmbyer në Nigeri që u vra gjatë muajit të fundit. Lajmi i këtij ekzekutimi erdhi pas një përpjekjeje të vazhdueshme nga ICRC për të siguruar lirinë e tre punonjësve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë edhe një thirrje të minutës së fundit për mëshirë të dielën në grupin e provincës perëndimore të Shtetit Islamik, por pa asnjë doli. Punonjësja e ndihmës, Hauwa Mohammed Liman mbahej peng që nga marsi i vitit 2018. Ajo u rrëm-

### DREJTORI RAJONAL I ICRC PËR AFRIKËN

"Ne apeluam për mëshirë. Si mund të ndodhë që dy punonjës të shëndetësisë u vranë pas gjithë negociemeve?! Ne i bëjmë thirrje grupit që mban Alice dhe Lea t'i lirojnë menjëherë", tha Danzi.

bye në një sulm në qytetin verilindor të Rann më 1 mars, së bashku me Saifura Husaini Ahmed Khorsa dhe Alice Loksha. Saifura u vra një muaj më parë, më 16 shtator, ndërsa Alice është akoma peng, së bashku me Leah Sharibu, një nxënëse 15-vjeçare i rrëmbyer nga grupi në shkurt. Hauwa dhe Saifura puno-

nin në një qendër të kujdesit shëndetësor të mbështetur nga KNKK-ja (ICRC), ndërsa Alice punonte në një qendër të mbështetur nga UNICEF "Asgjë nuk mund ta justifikojë këtë", tha drejtori rajonal i ICRC për Afrikën, Patricia Danzi. "Ne apeluam për mëshirë. Si mund të ndodhë që dy punonjës të shëndetë-

sisë u vranë pas gjithë negociemeve?! Vdekjet e tyre nuk janë vetëm një tragjedi për familjet, por edhe një mungesë për mijëra njerëz në Rann dhe në zonat e tjera të prekura nga konflikti në Nigerin Verilindore, ku qasja në kujdesin shëndetësor mbetet një sfida. Ne i bëjmë thirrje grupit që mban Alice dhe Lea për t'i liruuar ata", tha Danzi. Gjithashtu, përmes zëdhënësit të tij, sekretari i përgjithshëm, Guterres e dënon ashpër vrasjen e një punonjësi të ndihmës nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) në Nigerin Verilindore. Ai u shpreh ngushtëllimet e tij më të thella familjes, miqve dhe kolegëve



të zonës Liman dhe shpreh solidaritetin me presidentin dhe stafin e KNKK-së. "Ata që janë përgjegjës për këtë vrasje duhet të sillen para drejtësisë", tha ai. Sekretari i përgjithshëm shprehet i shqetësuar për sigurinë dhe mirëqenien e pengjeve dhe

bën thirrje për lirinë e tyre të menjëhershme. Ai thekson se të gjitha palët në konflikt duhet të mbrojnë punonjësit që sigurojnë ndihmë humanitare për të shpëtuar jetën e miliona njerëzve në nevojë në Nigerin Verilindore.

Që në 2001 që shitej kanabisi mjekësor, tashmë miratohet me ligj

# Kanadaja legalizon përdorimin e marijuanës rekreative

Fitim 400 mln USD, Trudeau mban premtimin

Ditën e djeshme Kanadaja u shndërrua në vendin e dytë në botë, pas Uruguait, që legalizon shitjen dhe përdorimin e kanabisit. Ligji ka hyrë në fuqi këtë të mërkurë, ndërsa marijuana mjekësore ka që në vitin 2001 që është në shitje. Megjithatë, vazhdojnë të mbeten ende shqetësime, duke përfshirë këtu mundësinë e forcave të policisë për të kapur ata që ngasin makinën nën efektin e kanabisit. Bashkitë kanadeze kanë muaj që përgatiten për t'i dhënë fund ndalimit të kanabisit. Legalizimi i kanabisit përbush premtimin e fushatës së 2015-ës të kryeministrit kanadez, Justin Trudeau, liderit të partisë udhëheqëse, Partisë Liberale. Kryeministri është shprehur se ligji i mëparshëm që ndalon përdorimin e kanabisit nuk ka qenë efektiv, duke marrë parasysh që kanadezët janë ende ndër përdoruesit më të shumtë të kanabisit. Ai tha se ligji i ri është menduar për ta mbajtur drogën larg minoronëve dhe larg përfitimeve të kriminelëve. Qeveria parashikon gjithashtu se shitja e kanabisit do të sjellë afërsisht 400 milionë dollarë çdo vit në buxhetin e shtetit. Informacione rreth ligjeve të reja dhe fushatave të ndërgjegjësimi publik u janë dërguar rreth 15 milionë familjeve. Pavarësisht le-



galizimit, ka ende shqetësime, përfshirë edhe gatishmërinë e forcave të policisë se si duhet t'i trajtojnë rastet e drejtimit të mjetit nën efektin e drogës. Disa çështje kyçe se si do të funksionojë shitja e kanabisit në Kanada mbeten pa përgjigje. Agjentët parashikojnë mungesë të marijuanës rekreative në treg në vitin e parë të legalizimit, pasi prodhimi vazhdon të rritet për të përbushur kërkesën. Provincat kanadeze dhe komunat po përgatiteshin prej muajsh për

ligjin e ri, që i hapi rrugë përdorimit të marijuanës rekreative. Provincat janë përgjegjëse për përcaktimin e shumë detajeve, ku kanabisi mund të blihet dhe konsumohet brenda juridiksioneve të tyre. Uruguai është vendi i parë në botë që ka legalizuar kanabisin rekreativ, edhe pse Portugalia dhe Holanda e kanë dekriminalizuar këtë lloj droge. Kanabisi rekreativ është lloj droge që merret për qëllime të kënaqësisë personale dhe jo për qëllime mjekësore. Kanabisi rekreativ nxit

efektet e kënaqësisë, halucinacioneve, gjumin, oreksin, nuhatjen e shijen. Këto efekte zgjasin zakonisht për rreth 6 orë. Por, përdorimi i vazhdueshëm i kanabisit rekreativ shkakton varësi ndaj drogës, humbje të vigjilencës dhe dobësim të kujtesës. Ndërsa, legalizimi i kanabisit është një çështje që ngrihet në shumë vende të botës, por shumë pak prej tyre e kanë kaluar këtë cak. Në Europë destinacioni i lirisë për përdorim, shitje, apo konsum në zona të kufizuara është Holanda.

Ekspertët në botë, kur vihen para debateve të legalizimit të kanabisit, goftë edhe për qëllime medicinale, mbi gjithçka theksojnë se duhen forcur disa instrumente që lidhen me kontrollin e kultivimit, forcimin e shtetit ligjor si dhe injektimi i një mendësie të re në popullatë, që pavarësisht legalizimit, nuk duhet të promovohet. Kjo ndodh në çdo vend të zhvilluar që e ka legalizuar, por kur një çështje e tillë ngrihet në Shqipëri, pikëpyetjet janë të mëdha. Kjo më tepër lidhet me kushtet në të cilat ndodhet Shqipëria, pra mundësia e monitorimit, kapacitetet e institucioneve dhe mentaliteti. Nëse këto nuk janë aty ku duhet, kjo mund të kthehet në një bumerang kërcënues. Vende që e kanë të legalizuar që nga konsumimi të shitja, transporti apo prodhimi, ishin dy Uruguai dhe Koreja, ndërsa tashmë prej ditës së djeshme i shtohet dhe Kanadaja. Australia ka të njëjtën praktikë sa i përket prodhimit për qëllime mjekësore, por sa i përket konsumit, ka lënë një hapësirë të vogël. Çdo australian ka të drejtë të arris deri në dy bimë për konsum personal.

## Krime/ Të shtëna me armë në kolegji, humbin jetën 19 persona

Një shpërthim ka ndodhur në një kolegji në Krime, duke shkakuar 10 të vrarë dhe të paktën 50 të plagosur. Sipas autoriteteve ruse të Antiterrorit, shpërtheu një pajisje eksplozive e paidentifikuar ende. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitri Peskov tha se hetuesit po konsiderojnë mundësinë e një sulmi terrorist si shkakun e mundshëm të kësaj ngjarje. Mediat lokale raportojnë se para shpërthimit të fuqishëm, u dëgjuan të shtëna me armë zjarri. Ndërkaj është zbardhur pista e të shtënavave. Të paktën 19 persona kanë ndërruar jetë dhe dhjetëra të tjerë janë plagosur, pas një sulmi me armë në një kolegji në Krime dhe aneksuar nga Rusia. BBC raporton se autori i sulmi është identifikuar si Vladislav Roslyakov, i cili ka hapur zjarr mbi nxënësit e shkollës teknike përpara se të qëllonte për vdekje veten. Miq të autorit të masakrës kanë rrefyer se ai e urrente shkollën teknike dhe se mund të ketë qenë në gjendje të rënduar psikologjike. Fillimisht dyshohej se ishte një akt terrorist, por më pas hetuesit e klasifikuan si vrasje masive. Sipas zyrtarëve lokalë, pjesa më e madhe e viktimitave janë nxënësit e shkollës teknike, ku studiojnë rreth 850 adoleshentë. Të gjitha shkollat dhe kopshtet u evakuuan pas ngjarjes në qytet. Presidenti rus Vladimir Putin, shpreh ngushtëllimet për të afërmit e viktimave.

### Veliaj: Disiplinim i shitjeve nga tregtarët

## Tregtim i produkteve bio në hyrje të Tiranës, në fundjavë s'ka taksa për fermerët

Cdo fundjavë fermerët e kryeqytetit do të mund të tregtojnë produktet e tyre në disa pika hyrëse të Tiranës pa paguar taksa. Bashkia e Tiranës do të ngrejë tregje të posaçme për shitjen e produkteve bujqësore bio. Kjo nisim, e cila u vjen në ndihmë fermerëve të zonës, i jep një dorë ekonomisë lokale dhe disiplinon shitjen e tyre produkteve, u bë me dije në panairin e organizuar me gatime, prodhime dhe punime artizanale të organi-

zuar në njësinë Baldushk. "Do të shfrytëzojmë të gjitha hyrjet në Tiranë; nëse Dajti dhe Shëngjegji e kanë hyrjen nga Kinostudio, bashkë me njësitë 3 dhe 4 do të ngremë një treg për të shunën dhe të dielën, në një vend që e cakton bashkia, që tregtarët të shesin sa të duan, pa pagesë. Nëse nga Rruga e Elbasanit e ka aksesin Baldushku, Bërzhitë, Farka, Petrela, Krraba, atëherë

diku në hyrje të rrugës së Elbasanit do të ngremë një treg, ku në fundjavë të shitjen të gjitha produktet bio. Pra, edhe shesim produktet, edhe nuk shpërndahemi në çdo hyrje pallati, ku sigurisht edhe për banorët është një lloj bezdie", -theksoi Veliaj. Ndërsa, Ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi u shpreh se modeli i ndërtuar nga Bashkia e Tiranës do të duhet që të replikohet edhe nga

njësitë e tjera lokale. "Bashkia e Tiranës ka ndërtuar një model të cilin duhet ta bëjnë të gjithë kryetarët e bashkive, në të gjithë Shqipërinë; duke nisur nga një produkt, nga gjeli i detit të këtij fshati, arriti ta vendosë atë shumë shpejt në qendër të vëmendjes të gjithë Shqipërisë. Kjo do të thotë të ndërtohet marketing, biznes, ekonomi. Sikur t'i kthejmë të gjitha ato në produkte që



sjellin të ardhura, që shiten, të ndërtojmë tregje të reja atje ku ka mundësi, ku ka njerëz, atëherë në fshat, ditë pas ditë, do të arrijmë të ndërtojmë arsyet se pse familjet që jetojnë në fshat nuk duhet të ndihen që kanë bërë një zgjedhje të

gabuar, por duhet të ndihen që kanë bërë zgjedhjen e duhur", -tha ai. Në njësinë e Baldushkut, së shpejti, Bashkia e Tiranës do të nisë investimin për ndërtimin e qendrës së komunës, për ta kthyer në atraksion turistik.

Avokatja e Popullit: Të përcaktohet minimumi jetik. Nikolla: Të rritet buxheti arsimor

Në Ditën Botërore kundër Varfërisë, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi u shpreh se qeveria ka ndërmarrë disa reforma në 5 vitet e fundit në lidhje me problemet e mirëqenies dhe uljen e numrit të familjeve të varfra. Aktualisht, në Shqipëri mijëra familje trajtohen me ndihmë ekonomike, ndërsa në 6 muajin e parë të këtij viti u përfshinë në skenë 52 700 familje. Ruçi tha se është ulur informaliteti dhe se duhet të bëhet më shumë që varfëria të ulet përmes zhvillimit dhe shfrytëzimit të pasurisë kombëtare. "Të reflektojmë dhe të rrisim mbështetjen e Kuvendit për përmirësimin e legjislacionit për këto fusha. Qeveria ka ndërmarrë disa reforma në 5 vitet e fundit në lidhje me problemet e mirëqenies. 200 mijë kontribuues janë shtuar në skemën e pensionit duke luftuar informalitetin. Është e nevojshme që të punojmë që varfëria të ulet përmes zhvillimit dhe shfrytëzimit të pasurisë kombëtare. Kreu i Kuvendit shtoi se problemi i vendit tonë nuk janë të pasurit, siç interpretohet, por problemi janë të varfrit. "Ne nuk synojmë të pakësojmë numrin e të pasurve, por të pakësojmë numrin e të varfërve. Duhet më shumë mbështetje për fermerët, të cilët duhet të paguajnë edhe kontributet. 400 mijë fermerë janë futur në skemën e pensionit. Të shfrytëzohet më mirë mundësitë në fshat", -tha Ruçi.

#### PUNËSIMI

Ndërkohë gjatë tryezës së punës të organizuar nga Kryetari i Kuvendit Ruçi, me fokus uljen e varfërisë, zv. kryeministria Senida Mesi theksoi se punësimi është shumë më i rëndësishëm sesa ndihma ekonomike që mund ti jepet të varfërve. "Punësim në vend të ndihmës ekonomike. Është objektiv i qartë i qeverisë për të ndihmuar të gjitha familjet në nevojë. T'i japësh njerëzve në çdo pjesë të botës mbështetjen e duhur që ata të dalin nga varfëria është thelbi i zhvillimit të qëndrueshëm ndaj dhe përcaktohet në objektivin kryesor "No poverty". Ky ob-

# Dita Botërore e Varfërisë, Ruçi: Të pakësojmë numrin e të varfërve

## Senida Mesi: Punësimi i kësaj kategorie, fokusi kryesor



Dje në Ditën Botërore të Varfërisë




#### ERINDA BALLANCA

Avokatja e Popullit këmbënguli në përcaktimin e minimumit jetik. "Unë e kuptoj që fondi është ai që është, por edhe ju duhet ta kuptoni që njerëzit nuk jetojnë dot me këtë vlerë të ulët"- u shpreh Erinda Ballanca.



#### LINDITA NIKOLLA

"Ne duhet të rrisim buxhetin për arsimin. Reforma jonë arsimore dhe treguesit e saj për çdo fëmijë nga 3- 18 vjeç dhe në arsimin e lartë po jep çdo ditë rezultatet e veta. Ne sivjet adresuam klasat kolektive. 345 klasa kolektive u mbyllën", -tha Nikolla.



jektiv përqendrohet tek strategjitë e ndërlydhura, përfshirë promovimin e sistemeve të mbrojtjes sociale, punësimin e duhur dhe ndërtimin e tyre për të ndihmuar në daljen nga varfëria", -tha numri dy i qeverisë. Më

tej ajo shtoi se axhenda 2030 dhe dinamikat e integritetit të Shqipërisë në BE kanë mbështetur në mënyrë reciproke rritjen e shpejtë ekonomike dhe përmirësimin e rëndësishëm në standardet e jetesës. Mesi u ndal tek re-

forma e ndihmës ekonomike, realizuar në bashkëpunim me Bankën Botërore. "Ky projekt mbështeti përpjekjet e qeverisë për të targetuar në mënyrë më efikase burimet për shtresën më të varfër dhe në nevojë, duke përfshirë në

Programin e Ndihmës Ekonomike, të varfrit që ishin përjashtuar me parë dhe duke pastuar skemën përmes reduktimit të rasteve të mashtrimeve dhe gabimeve", -tha Mesi. Sakaq, Avokatja e Popullit këmbënguli në përcaktimin e minimumit jetik. "Unë e kuptoj që fondi është ai që është, por edhe ju duhet ta kuptoni që njerëzit nuk jetojnë dot me këtë vlerë të ulët"- u shpreh Erinda Ballanca. Ndërsa Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla foli për nevojën e rritjes së buxhetit arsimor. "Ne duhet të rrisim buxhetin për arsimin. Reforma jonë arsimore dhe treguesit e saj për çdo fëmijë nga 3- 18 vjeç dhe në arsimin e lartë po jep çdo ditë rezultatet e veta. Ne sivjet adresuam klasat kolektive. 345 klasa kolektive u mbyllën", -tha Nikolla.

#### Gara për shefat e shërbimit në QSUT, opozita: Në komision janë miqtë e Ramës

Ditën e nesërme nis aplikimi për 41 pozicione shefa shërbimesh mjekësore në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Pas shpalljes së kritereve nga Ministria e Shëndetësisë, akuzat të forta kanë ardhur nga opozita. Sipas ish-kryeministrit, Sali Berisha ky është superskandali i radhës në komisionin përzgjedhës, nga 5 anëtarë, 4 prej tyre nuk janë mjekë. "Si mundet që një komision me këtë përbërje (E. Joti-inxhinier, E. Hoxha-ekonomiste, E. Tola-juriste, E. Vasha-jo mjekë dhe vetëm prof Xh. Draçini-mjek) të gjykojë dhe vlerësojë projektet për zhvillimin dhe drejtimin e 41 shërbimeve që të specializuar dhe të veçanta për gjithë shërbimin kombëtar shëndetësor", -shkruan Berisha në faqen e tij në rrjetin social Facebook. Edhe deputeti i PD-së, Bardh Spahia, thekson se indiferenca e Ramës ndaj bluzave të bardha nuk njeht kufij. "Urrejtja e Ramës ndaj bluzave të bardha dhe indiferenca e tij ndaj shërbimit shëndetësor nuk njohin kufij. Arrijnë deri aty sa shkelen parimet e pavarësisë së shërbimeve dhe klinikave universitare në përbërjen e të cilit është vetëm një mjek dr. Draçini, kurse pjesa tjetër e anëtarëve janë aty për merita pa asnjë lidhje me mjekësinë, por për faktin që janë miq të Ramës apo ministres Manastirliu", -shkruan Spahia në rrjetin social 'Facebook'.



## BOTIMI

Prezantimi i botimit në kulmin e debateve mbi policinë dhe krimin e organizuar

# Policia përballë sfidave të krimit...dhe të politikës

Këto muaj kur i gjithë diskursi politik, rrjedhimisht edhe ai i shoqërisë, është fokusuar te situata e krimit dhe puna e policisë, të krijohet bindja se ekspertët e sigurisë janë të panumërt në Shqipëri. Lumenj akuzash në parlament, deklarata shtypi nga selitë e partive, kryeministri që drejton mbledhje me transmetim live me krerët e policisë, deputetë e kryetarë partish që përleshin në studio me analistë shumëfunksional, të gjithë këta rreken të analizojnë situatën e rendit dhe sigurisë, krimin e organizuar, kurbat e statistikave, vrasjet në ish-bloq etj. Ndërkohë, ekspertët e vërtetë janë ftuar që të ndjekin këto përplasje të përnatshme në studio televizive e takime publike vetëm si spektatorë, apo më e keqja, ashtu si gjithë qytetarët e tjerë nga divani i shtëpisë së tyre të mbërthyer gojëhapur nga telenovela e krimit të organizuar.

Pikërisht në këtë periudhë kur të gjithë prozhektorët janë drejtuar nga policia dhe roli i saj, vjen për publikun një botim shkencor i titulluar "Policimi dhe çështjet e sigurisë", i dy ekspertëve të mirëfilltë të policisë, z. Bilbil Memaj dhe z. Hasan Shkëmbi. Ky libër që kurorëzon një punë të vlerësuar shkencore dhe një karrierë të gjatë të autorëve në drejtimin e policisë, u prezantua dje në ambientet e Akademisë së Shkencave me pjesëmarrjen e studiuesve dhe personaliteteve të fushës së sigurisë dhe përfaqësuesve të institucioneve të rëndësishme vendase dhe ndërkombëtare.

Duke shfletuar librin mund ta kuptosh mjaft lehtë se autorët nuk e kanë zgjedhur qëllimisht këtë periudhë fokusimi të politikës ndaj policisë për të publikuar

*Bilbil Memaj sjell një libër të ri mbi çështjet e sigurisë*



Dr. Bilbil Memaj, rektor i Akademisë së Sigurisë

këtë botim që trajton në mënyrë shkencore dhe shteruese shumë prej pikëpyetjeve që shtrohen sot për krimin dhe rolin e policisë. Por, rasti thonë se është mbreti i botës, dhe ky libër ka qëlluar në momentin e duhur për të shërbyer jo vetëm si një material studimor për trupën e policisë, por edhe si një botim me interes për të gjithë lexuesit që dëshirojnë të eksplorojnë më shumë në këtë fushë.

Ashtu siç e thekson akademiku Moikom Zeqo në fjalën e tij gjatë promovimit, mënyra se si bashkëautorët e kanë shtjelluar lëndën në tërësi dhe tematikat e veçanta, është domethënëse dhe tregon shumë, si për maturinë e mendimit ashtu edhe për anën mjeshtrorë në ofrimin e subjektit, mbi një çështje që paraqitet tepër tërheqëse jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë, siç është tema e policimit dhe

sigurisë. Për realizimin e këtij botimi autorëve u është dashur të shfrytëzojnë një literaturë të pasur ndërkombëtare si dhe të marrin në konsideratë përvojat më të

pranuar sfidat e reja të këtij qytetërimi, në fushën e sigurisë publike dhe asaj kombëtare.

"Gjeneral" Bilbil Memaj, aktualisht rektor i Akade-


## PREZANTIMI

Botimi shkencor i titulluar "Policimi dhe çështjet e sigurisë", i dy ekspertëve të mirëfilltë të policisë,

Dr. Bilbil Memaj dhe Dr. Hasan Shkëmbi, kurorëzon një punë të vlerësuar shkencore dhe një karrierë të gjatë të autorëve në drejtimin e policisë. Libri u prezantua dje në ambientet e Akademisë së Shkencave me pjesëmarrjen e studiuesve dhe personaliteteve të fushës së sigurisë dhe përfaqësuesve të institucioneve të rëndësishme vendase dhe ndërkombëtare.

mira të policimit përëndimor: Prej kësaj ata kanë arritur të përcjellin qasjen e tyre duke i përafëruar ato me teorinë më të fundit mbi policimin në shoqërinë e globalizuar të mijëvjeçarit të ri, si dhe duke

misë së Sigurisë, sjell në këtë libër një eksperiencë të gjatë në sektorin e policisë, duke mbajtur pozicione të ndryshme drejtuese, nga të cilat sigurishi më i vlerësuar ai si Drejtor i Përgjithshëm i



Policisë së Shtetit. Gjithashtu, edhe z. Hasan Shkëmbi, numëron mbi 40 vite në karrierën e tij në strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe policisë me arritje të shumta profesionale.

Duke ndërthurur këto dy eksperiencat të gjata në strukturat e policisë si dhe kërkimit dhe mësimdhënien e përditshme, sigurishi që ky publikim nuk mund të mbetet jashtë zhvillimeve dhe realitetit të kohës. Në brendësi të librit, mund të gjenden reflektimet mbi raportet e policisë me politikën dhe shtetin, të cilat ndikojnë sigurishi në kontributin e Policisë së Shtetit në mjedisin e sigurisë, besimin e trupës ndaj drejtuesve apo edhe të qytetarëve ndaj uniformave blu.

Rekomandimet e autorëve nënvizojnë problemin e ndikimit të politikës në drejtimin e policisë (në rastin e partisë në pushtet) apo edhe në politizimin e dëmshëm të veprimeve të policisë (në rastin e opozitës). Është pikërisht ky politizim dhe retorikë e panevojshme e betejave të partive politike, që krijon premisat për zhvlerësimin e profesionalizmit

të policisë. Të gjitha këto të përkythura në një trupë policore, që nuk ka besim tek drejtuesit e saj dhe, gjithashtu, nuk gëzon besimin e qytetarëve. Karriera e gjatë e "gjeneral" Memajt, me ulje-ngritje sipas rrotacioneve politike, është shembulli më i mirë për të analizuar jo vetëm rrugëtimin e policisë në këto 35 vite të fundit, por edhe rolin dhe ndërhyrjet antiligjore dhe arrogante të politikës në polici.

Sigurishi që ndërtimi i një strukture profesionale të policisë do të jetë sfidë edhe pasi politika të jetë kthyer në hullitë e saj tradicionale të debateve ideologjike dhe programore. Derisa kjo të ndodhë, për fat të keq, nuk duket se do të jetë një tërheqje e shpejtë, trupa e policisë duhet të rrisë aftësimin dhe profesionalizmin e saj në përballjen me rreziqet e reja të sigurisë publike. Libri i fundit i Memajt dhe Shkëmbit, është një kontribut i vlefshëm në këtë drejtim dhe do të mbetet si një gur i rëndësishëm themeli për të ardhmen e policimit profesional.

**Erjon Tase**



Gjatë prezantimit të djeshëm të librit "Policimi dhe çështjet e sigurisë"



VENDIMI I QEVERISË

# Zhbëhet qendra historike e Tiranës, u hapet rrugë ndërtimeve në ish-monumente

Fatmira Nikolli.

Një vendim qeverie i datës 3 tetor, publikuar së fundmi në Pletoren Zyrtare ka rrudhur ndjeshëm qendrën historike të Tiranës dhe zonën e mbrojtur rreth saj. Nga Ministria e Kulturës, "Gazeta Shqiptare" ende nuk mundur të marrë një zë specialisti që të sqarojë se cilat janë arsyet e kësaj VKM-je, e hartuar dhe miratuar pas asaj të një viti më herët. Megjithatë, përtej rreshtave e neneve që janë pakësuar këtë herë, specialistë të besueshëm të trashëgimisë kulturore, të kontaktuar nga "GSH" në kushte anonimati, pasi kanë krahasuar dy zonifikimet, kanë bërë me dije se tkurja e zonës së mbrojtur është e frikshme.

"Nxjerrin nga mbrojtja mjedisin e Muzeut Kombëtar, të gjithë zonën anash dhe mbrapa Pallatit të Kulturës, parqet e gropës së Hajdin Sejdisë, zonën e mbrojtur midis Kacelit, 'Ushtarit të Panjohur' dhe Bibliotekës Kombëtare, parqet para Parlamentit deri te ura e Tabakëve. Gjithashtu, e gjitha zona e gjelbër dhe sportive (fusha e Pallatit të Pionierëve) përgjatë Lanës deri te Rruga e Elbasanit, vilat e ish-Bllokut nga Lana deri te Instituti Arteve, zona e Gardës dhe parku mbrapa korpusit qendror të universitetit, zona e gjelbër dhe me vila mbrapa dhe anash ish-'Sheratonit', fusha e gjelbër mbas Kryeministrisë dhe brezi me vila nga piramida deri te stadiumi", thotë një specialist për "Gazeta Shqiptare".

Një tjetër specialist i kontaktuar nga "GSH" shtoi se zonifikimi i ri sipas VKM-së, duke qenë se nuk ka në mbrojtje anët rrethuese të Kullës së Sahatit u hap rrugë ndërtimeve edhe aty. Qeveria në këtë mënyrë rrezon vetveten, sepse në fillim të këtij viti, me Ligjin e ri për Trashëgiminë Kulturore, premtoi të ishte e rreptë me shkelësit e parimeve dhe neneve në mbrojtje të trashëgimisë, duke saktësuar madje me krenari edhe përfshirjen në ligj të peizazhit historik, që me këtë VKM dhe me ato të tjerat para kësaj, i vënë flakën një herë e përgjithmonë. Ç'peizazh po ruhet me ligjin e ri, kur gjithë ç'njihej nga ky qytet, po shformohej në mënyrë të parikthyeshme?

Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, përmes një reagimi të shkurtër e cilëson si "Anarki totale në fushën e trashëgimisë. E gjitha në emër të modernizimit oligarkesq, degradues për një qytet të brishtë, me pak trashëgimie dhe pa hapësira të gjelbra, si Tirana. Anarki e ndërtuar me kujdes, e imponuar nga lart, në institucionet mbrojtëse, të cilat janë shndërruar në "pëshptomore ambulance". Bie zona e mbrojtur e Tiranës pas 19 vjet lufte (1999-2018)".

**ÇFARË ËSHTË NË MBROJTJE**

*Specialistët e trashëgimisë: Tashmë mund të ndërtohet pranë Kullës së Sahatit, teatrit e ish-Pallatit të Pionierëve*


*Nga Muzeu te Biblioteka Kombëtare, nga ish-Pallati i Pionierëve te vilat e ish-Bllokut, çfarë humbasim*

Në VKM vihet në dukje se qendra historike në qytetin e Tiranës është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistike-arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit dhe arrijt në arkitekturë, si xhamia e Et'hem Beut, ndërtimet administrative dhe kulturore, të aksit monumental të viteve '30-'40, si dhe shembuj të spikatur të arkitekturës të pas viteve '50. Hapësira urbane e qendrës historike në qytetin e Tiranës përfshin ansamblin historik urban në bulevardin "Zogu I" dhe bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Sheshin "Skënderbej", Sheshin "Nënë Tereza"; Sheshin "Italia" dhe hapësirat e gjelbra. Parimisht, thuhet se plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Tiranës merr parasysh kufijtë e zonifikimit të qendrës historike, zonës së mbrojtur të saj dhe zonës arkeologjike A, të Kalasë së Tiranës. Neni përcakton në VKM "Ndërhyrjet në zonën mbrojtëse", ku "kryhen restaurime, adaptime, rikonstruksione dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj arkitektonike dhe funksionale, të cilat duhet të jenë në harmoni me vlerat e ansamblit, por: lejohet edhe ndërtim, rikonstruksion i rrjetit rrugor dhe i shesheve, për përmirësimin e infrastrukturës".

Çfarë do të thotë kjo? Nëse kalaja është qendër historike, zona përrreth saj është zonë mbrojtëse dhe në të lejohen ndërhyrjet e mësipërme. Sa i takon studimit, projektimit dhe zbatimit të punimeve në zonën mbrojtëse, VKM thotë se, "projektet e ndërtimeve të reja, rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit". Me gjasë ky është neni ku djalli fshihet në detaje.

**REAGIMI I PD**

Përmes një reagimi për mediat, zëdhënësja e Partisë Demokratike, Ina Zhupa, tha dje se, "të gjitha përpjekjet për të shkatërruar Teatrin Kombëtar, e heqin me VKM nga kategoria zona të mbrojtura. Nga sot e kemi godinë pa status dhe në bazë të planit urbanistik u hapet rrugë projekteve të ndërtimit që ka Rama dhe Veliq. Me vendimin nr.582, datë 3.10.2018 Këshilli i Ministrave ka miratuar 'Deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit të ruajtjes'. Në këtë VKM, qeveria ka përjashtuar godinën e Teatrit Kombëtar nga zona e qendrës historike të qytetit, duke mos



**ZONAT QË NUK MBROHEN MË**

- Mjedisin e Muzeut Kombëtar
- Zonën e Pallatit të Kulturës
- Parqet e gropa e Hajdin Sejdisë
- Zona pranë Bibliotekës, Parlamentit deri te ura e Tabakëve
- Fusha e ish-Pallatit të Pionierëve
- Vilat e ish-Bllokut deri tek Instituti Arteve
- Zona e Gardës dhe parku mbrapa korpusit
- Zona me vila tek ish-"Sheratonin"
- Brezi me vila nga piramida deri te Stadiumi

e vendosur askund në përbajtjen e VKM. Godina e Teatrit Kombëtar është njëri ndër njëri si një godinë pa status të trashëgimisë kulturore". Zhupa shtoi

se në vendim shihet harta treguese e zonimit të qendrës historike, zonën e mbrojtur dhe zonën arkeologjike, ku duket qartë që godina e Teatrit Kombëtar nuk ekziston në zonimin e qendrës historike. Sipas saj, qeveria me këtë VKM u ka hapur rrugë ndërtimeve që do të ndodhin në këtë zonë, duke u mbështetur kështu dhe në rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Bashkisë Tiranë, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit në 2017, ku në nenin 21 të kësaj rregulloreje përcaktohet që në këtë zonë lejohet miksimi i kategorive të strukturave të ndryshme si banime, hotele, agro-turizëm, qendra tregtare etj.

"Pavarësisht që Presidenti Meta e ktheu ligjin, pavarësisht antikush-tetutshmërisë, pavarësisht protestave të përditshme qytetare, Rama dhe Veliq vazhdojnë planin për t'i dhënë 'Fusha sh.p.k' kullat të trualli i Teatrit Kombëtar", përfundoi Zhupa.

## PËRKUJTOHET VEDAT KOKONA

20 vite pa shkrimtarin dhe profesorin Vedat Kokona. Në nderim të jetës dhe veprës së tij, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Kulturës organizuan në sallën franceze të Bibliotekës Kombëtare aktivitetin për të kujtuar këtë figurë akademike me shumë kontribute në jetën e vendit, i cilësuar shpesh edhe si ati shpirtëror i frankofonisë. Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla gjatë fjalës së saj në këtë aktivitet mori angazhimin për veprat që me vlerë të Vedat Kokonës që bënë krenar gjithë kombin, të jenë prezente në arsimin parauniversitar për brezin e ri, ndërsa do të ketë edhe ditë të dedikuara kushtuar profesorit Vedat Kokona në institucionet arsimore të mesme dhe të larta. "Angazhohem në detyrën dhe në cilësinë e ministres së Arsimit që këto vepra e tij të jetë një vepër që shërben për gjithë brezin e ri, ndoshta nga ky takim për të marrë shkas, për të mundësuar që në

kurikulën e arsimit parauniversitar profesori të jetë prezent. Aшту sikurse edhe nga kjo ditë në dalim me një vendimmarje apo me një angazhim të përbashkët që në sistemin e arsimit, unë s'do të veçoja as universitarin, por në të gjithë sistemin tonë edhe parauniversitar dhe atë të lartë, të vendosim ditë të dedikuara profesor Vedatit. Dita e Vedat Kokonës do të jenë ditë në të gjitha shkollat, ku jo vetëm mësohet gjuha frënge, por edhe në shkolla ku mësohet letërsia shqipe, sepse siç ju thaat, vlerat e shqipërimin të profesor Vedatit, ashtu si ai i sillte të mëdhenjtë e letërsisë në duart e brezit të ri dhe çdo lexuesi në Shqipëri, është bërë në mënyrën më ekselente të mundshme, sepse ai shqipëronte në mënyrën më ekselente", deklaroi Nikolla. Ndërsa ministria Kumboaro solli në vëmendje të pjesëmarrësve kujtimet që e lidhin me profesor Kokonën që nga ora e Fonetikës dhe deri tek fjalori Frëngjisht-Shqip dhe shtëpia

botuese e vajzave të tij. Nga ky takim, Kumboaro bëri të ditur se së shpejti për të nxitur leximin e veprave me vlerë do të ketë një fushatë të madhe të quajtur "Lëvizja kombëtare për lexim". "Po bëhemi gati për një fushatë leximi, takohemi për një libër për të nxitur leximin. Sivjet duam t'i jap një përmasë më të madhe dhe duam ta quajmë 'Lëvizja kombëtare për lexim'. Duhet të japim kontribut për leximin e librave nga brezat e rinj", deklaroi Kumboaro. Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe profesori Edmond Tupe, i cili vlerësoi Kokonën si një ndër poligrafet që preku shumë fusha të jetës dhe solli si trashëgimie për ditët e sotme vepra të rilindësve tanë. Ndërkohë, vajza e tij, Mimoza Kokona falënderoi organizatorët që kujtuuan 20-vjetorin e ndarjes nga jeta dhe 105-vjetorin e lindjes së babait të saj. Në shenjë mirënjohje, ajo dhuroi për bibliotekën një nga veprat e tij me shkrimet origjinale.



KRITIKË

# Shfaqja “Gratë”, kur regjia tejkalon tekstin

Nga Josif Papagjoni

Tetë aktore femra janë vendosur në paraskenë, në vijën ndarëse me sallën e spektatorëve. Kanë veshje të ndryshme, çka të shpie vetiu te ideja e kombeve dhe etnive të ndryshme, e vendeve të ndryshëm, e kulturave të ndryshme: dikush me veshje indiane, lindore, arabe, dikush me veshje moderne amerikane, evropiane; me shami, me kapele, me shall, me shifon. Janë të shtangura. Si statujat. Por i bashkon të gjitha një element: fasha e bardhë që jua ka mbyllur gojën. Pra, s'kanë të drejtë të flasin. Janë robina të pushtetit maskullor: Pushtetit të antropologjive arkaike, të kredhura në terrin e autoritetit dhe dhunës maskullore, të shpërfilljes, indiferencës së shoqërisë, pamundësisë, religjionit të keqkuptuar. Ato heqin fashat e bardha sipër gojës dhe këndojnë një këngë, kompozim i Aleksandër Lalos. E interpretojnë mjaft bukur, një dyzërësh harmonik, ku ngujohet trishtimi i thellë njerëzor, ku pikon një dhimbje e mallëngjim vramendës. Shikuesi e merr menjëherë atë çka është dashur të thuhet, breroren e mesazhit regjisorial të Qëndrim Rijanit; e kupton saora praninë e tij mbrojtëse e mbështetëse ndaj figurës së femrës në përgjithësi.

Ja kështu nis shfaqja e dramës “Gratë” e Teatrit Shqiptar të Shkupit. Jo shumë kohë më larg e kisha parë atë nën titullin “Femrat” nga teatri “A. Z. Çajupi” i Korçës me regjinë e Driada Dervishit. Por tjetër gjë ishte këtu. Regjia e kishte tejkaluar tekstin, e kishte moderuar gjegjësitë një ideje në dukje kundërvënëse, por në fakt përplotëuese, si një aureolë mbi krye martiriumesh për t'i dhënë dritë tjetër asaj çka ky tekst thoshte. Ai solli 8 drama, 8 brenga njerëzore, të nënkuptuara ose të bashkangjitura me arsyet e sjelljes së këtyre 8 personazheve gjatë rrjedhës së veprimit skenik. Në të vërtetë subjekti i dramës lëviz mes ankthit të femrave brenda një familjeje e shtëpie, për të rrëmbyer diçka ose gjithçka nga trashëgimia e një burri me të cilin janë të vendosura në raporte të ngushta: vjehrra, gruaja, motra, vajzat, mbesa, shërbyeset etj. Të gjitha ato janë kredhur në llomin e zhatjes dhe grabitjes, të gjitha syçelur ndaj njëra-tjetrës e të gjitha tinëzare, sekush t'i a punojë tjetrës, sekush me mendjen dhe sjelljen e fshehtë, me hiletë që ndjekin të gjitha së toku për t'i futur secila vetë paratë e trashëgimisë së të zotit të shtëpisë. Krijimi i një suspanse të bukur dramaturgjike ku dyshimi qarkullon sa nga e para tek e dyta dhe spektatori njihet çdo rast me një veprim diversiv, të fshehtë, por që zbulohet falë syçeljes së çdokujt dhe të gjithave njëherësh – kjo i jep ritëm të brendshëm psikik veprës. Regjia e mban ndezur këtë kod të trysnisë dhe kureshtjes. Duket sikur e vërteta po zbulohet cak pas caku dhe përmes detyrimit për t'u shpjeguar te të tjerat, secila nga femrat “shfaqësohet” pjesërisht



para syve tanë duke na rrëfyer, paralelisht me gjendjen dhe të fshehtën e saj, një brengë njerëzore harmuese në pamundësitë e shumta të jetës, posaçërisht të pozitës së femrës në shoqëri, në familje a përballë burrit. Në këtë mënyrë realizohet disa drama të përjetuara thellë. Dikush ruan aksionet e përfuturta si “letra të vdekuara” sepse ka frikë nga pasiguria e pleqërisë dhe nuk ia jep ato të zotit të shtëpisë për të shmangur një fallimentim të mundshëm, dikush lakmon një pjesë të trashëgimisë si grua legjitime edhe pse dashuron dikë tjetër, dikush ka mbetur udhëve me fëmijën e abortuar ose është divorcuar, dikush tjetër pret vdekjen e të zotit që diçka të zhvat nga kurvërimi i tij me të, dikush është viktimë e epsit incestual, dikush kërkon “pengun” nga vësh-tirësia e jetesës dhe e drejta e flir-it me kryefamiljarin etj. E gjithë kjo grupë e zezë veshesh, lakmish, tinëzish të ngjan si një shportë gaforresh që duan të kafshojnë njëra-tjetrën për të përfituar nga trashëgimia. Pushteti i parasë është i papërballeshëm, zvetënues. Ai e shprish njeriun dhe fisnikërinë e tij, i rrëzon përtokë mitet e harmonisë, dashurisë, familjes së moralshme dhe lë pas veçse gërmadha veshesh, ndyrësish, armiçësish. Në këtë sfond egërshan, përmes drama-ve gjithfarëshe, gjithsesi ne shohim njerimin e shpirttrave të këtyre 8 femrave të mbetura pa përkrahje, si hedhurinat, udhëve të pasigurta të fatit; shohim tablonë e fëlliqësisë dhe njëherazi të vrazhdësisë së jetës.

Po pse regjisori ka ndërhyrë në tekst? Ky është një problem tejet i njohur i leximit regjisorial të një teksti çfarëdo. Mendimet janë të ndryshme: një palë mbron tezën se regjisori mund dhe duhet të shtojë

## Gjetje mbresëlënëse e mesazhe të përbotshme

tekst në trupin ligjërimor të veprës për të theksuar e mbivendosur ide-të e tij, një palë tjetër mbron tezën se teksti s'duhet cenuar dhe theksat regjisoriale mund të dekodohen përmes nënshtrësive semantike regjisoriale mbi tekstin e dhënë. Qëndrim Rijani ka ndjekur udhën e parë. Ai ka shtuar enkas tekst të ri për çdo personazh-femër duke sajuar për secilin nga një historizë ose dëshmi të brengës shpirtërore që përfaqëson. Së bashku këto histori sjellim fragmente psikosociale të femrës së poshtërur a përballë autoritetit maskullist apo vetë antropologjisë kulturore të prapambetur ku femra shqiptare jeton. A ka bërë mirë? Mua më pëlqen mjaft dhe, madje, m'u dukën nga gjërat më të realizuara në shfaqje, çka vendoste mbi të njëjtin të trishtë, të zymtë, pikëllues e dramatik. Kësodore përmbajtja zhvendoseje dhe ushqente një ide plotëuese, që nuk lidhej me me veprimin konkret të pjesës, me intri-gën dhe subjektin e saj. E gjitha kjo ishte si një mbulesë, por që i shkoste shfaqjes dhe e kishte zbuluarur së tepërmi atë. Përpos kësaj, në këtë rast ka lëvizur krejt edhe mënyra e përjetimit, zhanri: nga komedi me një veprim të thukët hetues është kaluar në dramë psikologjike dhe depërtime në shpirtin e trazuar të graus nën trysni dhe dhunë. Trajtimi regjisorial ka ndikuar dukshëm në mënyrën e interpretimit të aktorëve, në theksat e vënë gjatë dialogëve, sidomos monologëve, duke e ofruar lëndën letrare fare pak në formatin e komedisë, përkundrazi në një trajtë të mirëfilltë drama-

tike. Ja, kështu është realizuar nga Q. Rijani, një mënyrë origjinale e leximit dhe trajtimit regjisorial të tekstit. Nga pikëpamja regjisoriale përveç një vendosjeje të figurave të aktorëve që krijojnë ritëm të brendshëm dhe aksion fizik, është synuar edhe për të profiluar karaktere të ndryshme të grave në problemet që ato kanë. Ani pse aktrimi ishte i drejtpërdrejtë nga 8 aktoret, gjithsesi shpikatën për një lojë të ndërë Vjollca Bekteshi Hamiti, Teuta Ajdini, Amernis Nikshiq. Imazhi regjisorial dhe ai aktorial e përplotësonte brengën e çdo personazhi duke krijuar tek çdonjëra syresh nga një histori të mëvetshme, e cila rrëfëhet përballë publikut me mikrofon dhe në tone të shqetësuar e psikologjike. Shkëputja e herëp-herëshme e veprimit të drejtpërdrejtë skenik dhe hedhja e tij në formën e rrëfimit për çdo personazh nuk e ka ngathtësuar shfaqjen, përkundrazi ja ka rritur vlerat artistike. Këto rrëfime shpesh bëhen në formë interaktive, pra tekta historia dramatike tregohet nga aktorja-personazh përballë spektatorit, pa pas saj zhvillohet forma vizive skenike e ngjarjes, sikundër është realizuar kjo me lindjen e një foshnje dhe vajtjen e lindjes si sakrificë dhe dashuri sublimë e nënës-femër ndaj pjellës së vet; rrëfimi i dëshimit të një barre, e mbajtur në tone të vrazhda me mjekët, veglat e ekzagjeruara e groteske të instrumenteve të operimit, copëtimin e trupit të fetusit tekta e nxjerrin nga barku i nënës dhe krimin që kryhet duke fajësuar

kështu gjithë infrastrukturën mjekësore legale apo ilegale, si dhe mendësinë që e pason dhe e mbështet atë. Paçka se episodi në fjalë ka dhe elemente të makabritetit, gjithsesi ai është dramatik në mënyrën e shprehjes dhe i qëllimshëm në zmadhimin që kryhet, për ta bërë kësaj më të lexueshëm apelin dhe vetë fenomenin e abortimit, i cili trajtohet si krim. Duke e ditur që veprimi skenik i kësaj pjese ka natyrë aktive, strukturohet në formë hetimi të shumëfishtë, shpërfaqet dhe zhvillohet përmes kureshtjes në rritje për të zbuluar të vërtetën, regjisori ka krijuar disa mizanskena interesante, ku plikset dramaciteti me elementet komike. Por herë-herë ajo, mizanskena, rrafshohet, vendoset ballazi, fiksohet, ngrin dhe lëviz disa më ngadalë, çka do të kërkonte që të mos e ulte dinamikën.

Një nga episodet më të realizuara të shfaqjes është zbulimi, impulsi instinktiv dhe shpërfaqja e ndjenjave të ndrydhura të dashurisë midis dy femrave që duken rivale dhe armike ndaj njëra-tjetrës, por që në fakt duhen fort. Duke u grindur, befaz ato puthen në ekstazën e një dashurie të anatemuar, të “ndaluar”, rrjedhimisht “amoralë”, nën trysni dhe të “ndëshkueshme” nga opinioni dhe shkalja e vetëdijes së kohës. Edhe dy aktoret që e luajnë këtë episode, Amernis Nikshiq dhe Vjollca Bekteshi Hamiti, krahas vërtetësisë së ekspozimit të veprimit të puthjes, ato kryejnë sipas mëdhe një akt emancipues për vetë spektatorin dhe shoqërinë tonë ende të paemancipuar e me një gravitet të rëndë maskilist.

Skenografia zhvillohet brenda idesë regjisoriale dhe shënon një gjetje mbresëlënëse. Përballë dhe nga sipër, si i gjenur në një kuti, janë rrvijëzuar hojet e bletës. Hoja të çon drejt mjalitit, të ëmblës, por edhe qumështit të bletës, edhe sh-traitit a mitrës ku ushqehet pjella e re, jeta e re. E pra, këto gra janë ëmblësia e jetës, sikurse janë qumështi që ushqejnë lindjet e reja dhe përtërijnë vetë jetën dhe gjen-eratat. Por, nga ana tjetër, i gjithë ky dekor domethënës, të krijojnë edhe përshtypjen e një ngujimi, e një mbylljeje brenda katër mureve, e një burgimi, sikurse në fakt është rëndom jeta e femrës shqiptare brenda mureve të rënda të konservatorizmit dhe mendësisë patriarkale. Atëbotë këto mure duhen rrëzuar. Sakaq, në këto hoje vendoseshin gjysmë të shtrira edhe figurat e aktorëve-femra, si nëpër vendet filjimi, varreza a tumula, të ngurosurat nëpër mure e themele “kështjellash” hijerënda antropologjike” që rëndojnë mbi jetën tonë. Në këto tri shtrësime semantike unë e dekodova skenografinë, përveç hijeshisë estetike që ajo kishte dhe një trajtimi fin të imazhit.

Opinion i Ditës


# Nacionalizmi e populizmi përballë kapitalizmit

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

...fenomeni "exit". Tashmë "Brexit" është në përmblyllje të procesit të tij, që ka shfaqur vështirësi konkrete, si përvoja e parë e tij. Në këtë mënyrë, fenomeni "brexit" është një fakt historik i përballjes së nacionalizmit e populizmit me kapitalizmin. Është fakt domethënës se, Gjermania e jo vendlindja e kapitalizmit është aktualisht mbrojtësja e vendosur e projektit evropian dhe e sistemit të vlerave, që përfaqëson modelin perëndimor në evolucionin e tij deri më sot. Abermas ka të drejtë kur pohon se nuk e prisja që populizmi ta mundte kapitalizmin në vendlindjen e tij. Dhe kjo tregon dhe flet shumë. Kuptohet roli i faktorëve kompleksë, sidomos i efekteve të krizës botërore, i akumulimit të shumë problemeve dhe sidomos ngecja e ecurisë së projektit evropian etj., por në këtë kompleksitet faktorësh evidentohet përkrahja e nevojës për reformimin e mëtejshëm të modelit perëndimor.

Ishte i shpejtë e disi i papritur, konkuzioni i shkurtër, që bënte publik drejtuesit kryesorë të modelit perëndimor në takimin e tyre për të shqyrtuar shpërthimin e krizës botërore të vitit 2008. Shkurt theksuan nevojën: "Ta bëjmë kapitalizmin më të moralshëm". Pas kësaj, nuk kishte ndonjë lëvizje konkrete shtimore apo e ndonjë lloji tjetër. Asnjë reflektim apo reformim në skemën e prodhimit shoqëror C+V+M dmth., në sferën e prodhimit, shpërndarjes e qarkullimit, të mënyrës së shpërndarjes së fitimit nuk u krye. Që nga ajo kohë, dukuritë e prirjet tërë shqetësuese të rënies së ritmeve të e të treguesve të zhvillimit ekonomik e rritjes ekonomike, në vende e rajone të ndryshme e në shkallë botërore, të treguesve të papunësisë, sidomos në radhët e të rinjve, të rritjes së nivelit, vëllimit, përmbajtjes e shtrirjes sociale të varfërisë, pasojat e krizave ciklike, thellimi e rritja drastike e pabarazive ekonomike, sociale e rajonale etj., vetëm e kanë bërë më të ndërlikuar e më problematike situatën ekonomike e sociale në nivele të ndryshme e shkallë botërore. Organizma të ndryshme ndërkombehtarë kanë evidentuar me shqetësim ekonomik e social teksta evidentojnë se 7000 fëmijë në ditë në botë, nën moshën 5 vjeç, vdesin nga kequshqyerja, apo që 124 milionë njerëz vuajnë nga uria akute, që 151 milionë fëmijë vuajnë nga kequshqyerja, apo që në çdo minutë 5 fëmijë në botë vdesin nga uria dhe 51 milionë nga dobësimi gradual i masës trupore. Problemet e mprehta ekonomike e sociale, në fakt kanë mpirë mendimin e veprimin vizionar e që mundëson përballimin e problemeve të lindura, ku ka mbetur vetëm alarmi e shqetësimi nga



lart e poshtë i shoqërisë perëndimorë. Klasat politike drejtuese, duke u ndjerë edhe si përgjegjëse për këtë situatë, në vend që të nxinin përqendrimin të reformimit i modelit dhe zgjidhjet e argumentuara shkencërisht, me një lloj çoroditje e dorëzimi përballë situatës, kanë kontribuar të lindin ide e qëndrime që kualifikohen si masa proteksioniste e luftëra tregtare. Dhe kjo ndodh në kushtet kur globalizmi ka avancuar së tepërmi. Është rritur e po bëhet më shqetësuese pasiguria sociale, ku në kushtet e mosreagimit shkencor, profesional e të përgjegjshëm, përfitues janë shfaqur jo ata që ndërmarrin veprime e programe, që përballojnë me efektivitetin problematikën, që po bëhet edhe më e mprehtë, por nacionalistë e sovranistë laramanë, që po fitojnë terren duke u shfaqur si dalës zot në përballimin e kësaj situatë e shqetësimeve në rritje nga qytetarët.

Është vërtet një zhvillim që tërheq vëmendjen, që një numër i dallueshëm e në rritje qytetarësh evropianë po mbështesin e votojnë programe politike që godasin hapur sistemin e vlerave, bazamentin e modelit evropian, në formë e qëndrime konkrete, siç është edhe mbështetja e qëndrimeve zyrtare, që nuk lejojnë vaborë të mbingarkuar me refugjatë të zbrasin në territorin e një vendi anëtar të BE. Edhe pse mund të jenë viktimë jo vetëm të keqeverisjeve totalitare e krizave konkrete, por edhe të manipulimit nga trafikantë njerëzish, janë qenie njerëzore që duhen ndihmuar. Mbështetja e qëndrimeve, partive politike, mendësive e programeve të këtij lloji, mbyllëse e në dëm të sistemit të vlerave janë vërtet të dëmshme e të rrezikshme. Këtyre qytetarëve u duhet kujtuar se mbështetja e këtyre frymëzimeve nacionaliste e kundër sistemit të vlerave është e dëmshme dhe mund të kthehet në shpejt edhe kundër tyre. Këto qëndrime bien hapur ndesh me nevojën e pjekur së tepërmi për ta bërë shoqërinë perëndimore më të moralshme. Këto dukuri dhe

bombat sociale janë shumë dëmshpëllyse e të rrezikshme, sepse mundësojnë edhe me mbështetje nga poshtë, daljen në skenë të aventurierëve politikë shumë të rrezikshëm e të dhunshëm.

Kjo situatë komplekse u bë terreni i përshtatshëm i rritjes së dallgëve të nacionalizmit e sovranizmit, që po luan me ndenjen e pasigurisë e frikës sociale në rritje, duke ofruar filozofinë e mbylljes nacionale, e tërheqjes nga interesat e shtetit-komb e duke dalë jo vetëm kundër integritimit, sistemit të vlerave, që përbën bazën e modelit perëndimor, por edhe duke u vendosur në pozicion edhe të goditjes së këtij sistemi të vlerave. Brenda kësaj situatë lindi fenomeni "exit", që u përqafua dhe po kurorëzohet i pari në hapësirën e BE në Britaninë e Madhe, vendlindjen e kapitalizmit dhe vendit me kontribut të rëndësishëm në fitoren mbi nazifazmin, si shfaqje ekstreme e nacionalizmit. Britania e Madhe ishte pjesë e rëndësishme e Kontinentit Evropian në periudhën e luftës së ftohtë 1, por që me përqafimin e fenomenit "exit" duket se i rrinte disi ngushtë projektin evropian. Po kështu, në Itali, një qeveri me profil nacionalist e sovranist, si dëshmi e rritjes së peshës së nacionalizmit në hapësirën e BE, po debatohet tashmë me strukturat e BE, lidhur me buxhetin e miratuar me frymëzime sovraniste e që nuk mban parasysh principet ekonomike të dakordësuar në hapësirën e BE. Nacionalizmi i sotëm po shfaqet aktualisht jo thjesht si mbrojtje nga ndonjë kërcënim nacional, por më shumë si një egoizëm kombëtar, ekonomik e kulturor. Është fakt se në hapësirën perëndimore është rritur pabarazia sociale, që i ka bërë grupe konkrete sociale të pafuqishëm ndaj grupit tjetër, që duke pasur pushtet ekonomik, siguron edhe më shumë pushtet real. Kjo ndeshmëri e vetëmbrojtjes së mjaft grupeve sociale, të goditur edhe nga papunësia në rritje, i nxit të bëhen pra e sloganeve sovraniste, nacionaliste e populiste, ku vetëruajtja

dinamike luan rol jo të vogël. Në këto kushte zë më lehtë vend kultivimi i individualizmit dhe egoizmi nacional.

Është domethënëse për treguesin e rritjes së dallgëve të nacionalizmit edhe një fakt tjetër interesant, që vjen nga disa vende të ish-kampit socialist, që sendërtuan modelin perëndimor pas rrëzimit të komunizmit, që po shfaqin dashuri të madhe për nacionalizmin e kanë mundësuar dukuri që dëmtojnë funksionimin e demokracisë dhe sundimin e ligjit dmth., më saktë të funksionimit real të sistemit të vlerave në vendet e tyre. Janë këta tregues, jo vetëm të rritjes së peshës së nacionalizmit e sovranizmit në hapësirën e BE, por edhe të goditjes së rëndë të modelit perëndimor të zhvillimit dhe bllokimit real të ecurisë së projektit evropian, që në thelb i ka shërbyer dhe i shërben integritetit të kontributeve, vlerave, aftësive e të interesave që bashkojnë e afrojnë njerëzit e popujt, evolucionit e reformimit të mëtejshëm të modelit perëndimor të zhvillimit. Është fakt që ecuria e projektit evropian e bëri kapitalizmin më të moralshëm dhe mungesa e guximit të shtyrjes përpara të tij u ka hapur rrugë jo vetëm nacionalizmave mbyllës e frenues të zhvillimit ekonomik-social, por edhe lindjes së prirjeve të rrezikshme, që mund të shkaktojnë dëme të pallogaritshme jo vetëm për vendet ku nacionalistët duan të fitojnë e të avancojnë, jo vetëm për vendet konkrete, por në tërësi për stabilitetin evropian e më gjerë.

Nuk është e vërtetë që materializimi i vlerave e bëri hapësirën e BE-së një shoqëri të majtë me një qeverisje të majtë, siç gjykojnë nacionalistët sot, që nxitojnë të fitojnë shumicën në strukturat evropiane, që të gpropisin përfundimisht projektin evropian. Jo sendërtimi funksional i sistemit të vlerave e afroji së tepërmi modelin kapitalist perëndimor me humanizmin, solidaritetin, me mbrojtjen e të drejtave të njeriut e sundim të

ligjit, ngushtoi hendeqet tepër të thella të pabarazive sociale, e bëri më njerëzor, më të drejtë, më të denjë, më të zhvilluar e më të moralshëm e tash duhet të avancojnë për ta bërë edhe më të moralshëm, siç konkluduan udhëheqësit kryesorë perëndimorë, kur të alarmuar shqyrtuan krizën botërore e financiare të vitit 2008. Filozofitë sovraniste mbyllëse e antiintegrim, që në emër të mbrojtjes së interesave të shtetit komb, frymëzojnë ndarjen nga sistemi i vlerave, vetëm ushqejnë stancione ekonomike, politike e sociale, kontradikta të mprehta e konflikte, që në kushtet e një përkëqësimit të mëtejshëm të zhvillimeve ekonomike u hapin rrugë e ushqejnë filozofi e praktika ekstremiste të rrezikshme. Me sjelljen e filozofinë e tyre, nacionalistët e sotëm po godasin rëndë nga brenda vetë kapitalizmin e po bëhen pengues realë të evolucionit të domosdoshëm të tij, si nevojë historike në përkrahje të vazhdueshme. Është koha për të parë dhe ecur përpara e jo për të kthyer kokën prapa.

Bashkimi e jo ndarja u duhet popujve evropianë. Dhe mësimi i historisë po shfaqet konkretisht edhe në lëvizje nga poshtë, si ajo që ndodhi në Berlin e disa qytete të tjera të Gjermanisë, nën parullën domethënëse "Unitebar" dmth., të pandashëm. Filozofia e kësaj lëvizjeje është shumë e qartë dhe domethënëse: "Kundër racizmit e ndarjeve". Mesazhi i qartë që u përcoll ishte: "Thuajme zë të lartë, ne jemi të pandashëm". Këtu nuk ka vend për nazistë. Vërtet është lëvizje që drejtohet problematikës në Gjermani, por ka vlerë evropiane, sepse dëshmon se po fillon një ndërgjegjësim nga poshtë, shumë i nevojshëm ndaj zhvillimeve të një problematike, që cenon sistemin e vlerave, që ushqen ndarjet, racizmin e mbylljen, por edhe që përmban kërkesën e të qëndruarit të bashkuar rreth sistemit të vlerave. Është një reflektim ky në drejtimin e duhur, në kohën e duhur, por dhe gjithashtu në vendin e duhur, që sot po mban shumë peshë në mbrojtjen e sistemit të vlerave dhe të projektit evropian.

Kjo lëvizje mund e duhet të ndihmojë për një zgjim e shkundje të vërtetë, sidomos të brezit të ri në të gjithë hapësirën evropiane e më gjerë, që nëse nuk reagon më shpejtë në mbrojtje të sistemit të vlerave e të projektit evropian që vë në mishëron atë, do t'i bëjë të keqen më të madhe të ardhshme së vet, modelit perëndimor dhe vetë njerëzimit. Projekti evropian e fuqizon, e shëndosh dhe i hap rrugë të vërtetë evolucionit të modelit perëndimor. Duket që brezi i ri mund të kontribuojë vërtet në hapje rrugë të një veprimi të mirëmenduar e organizuar, që e reformon, e përsos, e gjallëron së brendshmi dhe e fuqizon modelin perëndimor të sistemit të vlerave, e avancojnë më tej atë. Vetëm përpara, çdo hap prapa është vërtet një dëm i madh historik.

Më 17 tetor 2018



Opinioni i Ditës

Nga Marcel Fürstenau

(vijon nga faqja 1)

... - pra diktaturës komuniste në RDGJ. Në vitin 1998 u vendimi në Bundestag për të krijuar këtë fondacion, që do të merrej me ballafaqimin e 44 vjetëve të diktaturës komuniste, që filloi pas fundit të diktaturës naziste në vitin 1945 dhe vazhdoi deri në rënien e Murit të Berlinit në vitin 1989.

Fondacioni e mban emrin e partisë komuniste në RDGJ - Partia e Unitetit Socialist të Gjermanisë, SED e krijuar në vitin 1946 në territorin e okupuar sovjetik përmes shkrirjes së detyruar të social-demokratëve, SPD me komunistët, KPD. Themelimi i saj ishte një akt jo i lirë në zonën që në vitin 1949 u shpall si Republika Demokratike Gjermane, RDGJ, një diktaturë sipas modelit sovjetik.

**INFORMACIONE NË 14 GJUHË**

"Kujtesa si detyrë" - kjo është motoja e fondacionit federal. Bëhet fjalë për "përballjen e plotë me historinë, shkaqet dhe pasojat e diktaturës në zonën sovjetike të okupuar dhe në RDGJ, për të shoqëruar procesin e bashkimit të Gjermanisë dhe për të dhënë kontributin e duhur në përballjen me diktaturat në vende të tjera në parametra ndërkombëtare". Kjo është shkruar në faqen e internetit të fondacionit me informacione në 14 gjuhë.

Spektri i punës së fondacionit është shumë i gjerë. "Plotësisht Lindje - jeta në RDGJ" është i titulli i një ekspozite fotografike që në fillim të vitit u hap në Berlin. Skena të përditshme të jetës, në një vend që nuk ekziston më, të ofruara nga fotografi Harald Hauswand dhe historiani i muzeut të RDGJ-së, Stefan Woll.

**NË KËRKIM TË LUMTURISË PERSONALE**

Një vështrim i tillë i thjeshtë fotografik për jetën në lindjen gjer-

# Të mos e harrosh kurrë diktaturën



mane mund të të rrëfejë më shumë për thelbin e një diktature, se mjaft debate sociologjike dhe akademike. Edhe për këto debate fton fondacioni i përballjes me diktaturën rregullisht, për të dëgjuar dëshmitarët e kohës.

Por, me gjithë murin dhe telat me gjemba, mungesën e lirisë së udhëtimit dhe mallrave të luksisht 17 milionë gjermanë në RDGJ u përqopën sigurisht të gjenin lumturinë personale edhe në këto kushte. Edhe pushteti i gjithëfuqishëm që kërkonte të kishte në dorë partia komuniste, SED i kishte kufijtë e tij. Se sa krisje kishte pësuar sistemi, kjo u kuptua me përhapjen e shpejtë të revolucionit paqësor në vitin 1989. Një diktaturë që më 7 tetor kishte festuar 49-vjetorin e ekzistencës u fundos e gjitha. Një vit më vonë gjermanët festuan ribashkimin me flamujt gjermanë.

Vështrimi i RDGJ-së në një kënd 360 gradësh është tipik për punën e fondacionit. Një nga mbështetësit e tij është ministri i fundit i Jashtëm dhe i vetmi i zgjedhur në liri i RDGJ-së, Markus

Meckel. Sipas tij, koha e gjatë që kaloi me përballjen me diktaturën naziste ka pasur "shumë pasoja problematike", thotë Meckel. Prandaj ishim të vetëdijshëm se duhej shpejt dhe në mënyrë të plotë një përballje e duhur me diktaturën e RDGJ-së dhe "për të gjithë vendin".

**STASI NË LINDJE DHE PERËNDIM**

Meckel ka parasysh me këtë mendimin e përhapur në pjesën perëndimore të Gjermanisë, se diktatura e RDGJ-së është një temë lindore. Por nuk është kështu. Mjafton të kujtohet se Stasi i shtrinte tentakulat dhe sigurisht synonte të hetonte popullsinë e vet, por gjithmonë e kishte nën vëzhgim edhe armikun e klasës në perëndim. Pjesa më klasike e repertorit të Stasis ishte diskreditimi i shfrytëzuesve kapitalistë dhe luftënxitës në perëndim.

Se sa larg shkente krahu i Stasisit e tregon edhe afëra e spiunit Günter e Guillaume. Ai ia doli të ngjitej deri në postin e referentit personal të kancelarit të atëhershëm, Willy

Brandt (SPD). Zbulimi i oficerit të lartë të Stasisit në vitin 1974 shkaktoi një krizë të fortë qeveritare në Republikën Federale dhe çoi në dorëheqjen e kancelarit Brandt. Pushtetmbajtësit në lindje rrëzuan pikërisht atë njeri, që me politikën e tij të shtensionimit ishte kujdesur për afrimin mes Lindjes dhe Perëndimit në Gjermani dhe Europë.

**KUSH ISHTE ERICH HONECKER?**

Të rinjtë sot ndoshta nuk e dinë, se kush ishte Willy Brandt, laureat i çmimit Nobel për Paqen, apo kush ishte Erich Honecker, shprehjet me keqardhje Markus Meckel. Në një kohë që është e rëndësishme të "njohim të shkuarën tonë në të gjitha dritëhijet e saj për të kuptuar veten", thotë kryetari i bordit të Fondacionit Federal për Përballjen me Diktaturën. Në vështrimin pas bëhet fjalë edhe për të "kuptuar çështjet aktuale dhe për të tejkaluar sfidat".

Se sa të brishta janë shoqëritë demokratike edhe gati 30 vjet pas fundit të konfliktit Lindje-Perëndim e tregon forcimi i tendencave populiste si të majta, ashtu edhe të djathta në të gjithë Europën. Prandaj Meckel e sheh detyrën e fondacionit si një sfidë që rishtrohet gjithnjë nga e para.

Fokusi i punës së fondacionit këtë vit është 50-vjetori i shtypjes së Pranverës së Pragës. Po ashtu, unik është edhe publikimi i një albumi "Muzetë dhe vendet përkujtimore në kujtim të viktimitave të diktaturës komuniste", ku dokumentohen 119 vende përkujtimore nga 35 shtete. Në 20-vjetorin e themelimit zhvillohet edhe një ceremoni festive më 17 tetor, ku merr pjesë edhe presidenti gjerman, Frank-Walter Steinmeier.

**HOROSKOPI**

**DASHI**

Beqarët do kenë disa mundësi për aventura. Buxhetin do e menaxhoni më me kujdes falë ndikimit pozitiv të planetëve. Sot do të tregoheni me kërkues ndaj partnerit.

**DEMI**

Buxhetin nuk do të mund ta mbani nën kontroll, kështu që situata dhe për pasojë ankthi mund të bëhet kryefjalë e ditës. Stresi nuk i zgjidh problemet, por ju bën më kaotik.

**BINJAKET**

Ditë e bukur për të dashëruarit. Pasditë dhe në mbrëmje do ndodhin gjërat më të bukura. Buxheti do stabilizohet vetëm falë ndihmës se njerëzve të afërt.

**GAFORJA**

Gjendja financiare për fat të do të jetë optimale. Ata që janë në një lidhje do e forcojnë bashkëpunimin në çift dhe e gjithë kjo falë disa projekteve të përbashkëta.

**LUANI**

Financat do të jenë mjaft të mira. Puna e palodhur do të shpërblehet. Jeni shenjë që pas një durimi të gjatë, nuk toleroni padrejtësitë.

**VIRGJERESHA**

Beqarët duhet të përgatiten për një takim shumë të veçantë me personë pozitivë. Sa u përket parave, duhet të flisni sa më parë me disa specialistë që t'ju ndihmojnë të zgjidhni problemet.

**PESHORJA**

Gjërat nuk do të ecin ashtu siç e kishit parashikuar. Sot mund të merrni disa propozime për punë. Mund të merrni një rritje page që do ju kënaqë.

**AKREPI**

Në planin financiar disa yje do ndikojnë pozitivisht dhe do bëjnë që gjendja të mbetet e qëndrueshme. Jeta juaj në çift nuk do jetë shumë e qetë gjatë pasdites.

**SHIGJETARI**

Shmangni debatet e kota në punë dhe mos lejojnë që diskutimet të dalin jashtë kornizës së normale. Beqarët do kenë disa mundësi për të realizuar takime interesante.

**BRICJAPI**

Yjet parashikojnë një shumë parash për ju. Kjo do jua bëjë ditën shumë të bukur. Nga energjia pozitive, gjërat do ju ecin mbarë edhe në dashuri.

**UJORI**

Dashuria kërkon më shumë angazhim nga ana juaj. Nuk mund të nxirni asnjë justifikim përpara partnerit. Yjet do ju ndihmojnë tej mase që ta përmirësoni buxhetin.

**PESHQIT**

Tregoni kujdes me një çështje ligjore që mund ta kenë lënë pas dore. Dikush mund të përfitojë nga mungesa e vëmendjes, duke shkaktuar kaos në jetën tuaj.

Opinioni i Ditës

Mira Bregu- OKB, Gjenevë

Sarajevë- Bosnje-Hercegovinë BH, si palë në Konventën për ndalimin e minave kundër personave (e njohur edhe si Konventa e Ottawa), po ndërmerr një stërvitje kombëtare me palët e interesuara relevante pasi ka përcaktuar se nuk do të jetë në gjendje të përmbushë afatin e saj të pastrimit të minave në 1 mars 2019 . Me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe mbështetjen teknike të Njësisë për Mbështetjen e Zbatimit të Konventës, BH do të mbajë një Dialog Kombëtar të Aktorëve në Sarajevë, 18-19 tetor me pjesëmarrjen e mbi 60 partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Dialogu kombëtar i palëve të interesuara për Demininim Humanitar në Bosnjë dhe Hercegovinë do të zhvillohet nën drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes, autoritetet kombëtare të veprimit ndaj minave, qeveritë dhe partnerët e donatorëve duke përfshirë Kombet e Bashkuara dhe NATO-n, Ambasadorin e Zvicrës në BH si Kryetar i komitetit të pastrimit të minave të Konventës, operatorët e çminimit

dhe ekspertët e veprimit ndaj minave, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, përfaqësuesit e komuniteteve të prekura nga minat dhe të mbijetuarit e minave tokësore. Për dy ditë do mblidhen diskutime që synojnë dhënien e reagimeve ndaj BH për strategjinë dhe planet për të përmbushur angazhimet e pastrimit të minave sipas Konventës sa më shpejt të jetë e mundur.

Në axhendën e paketuar, autoritetet e BH do të paraqesin informacionet e fundit në lidhje me ndotjen e mbetur të tyre dhe atë që ajo e konsideron të nevojshme për të përmbushur ambicien e saj pa mina.

"Është e rëndësishme për ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e kësaj çështjeje në nivel kombëtar, për të treguar se ndërsa ne kemi kërkuar kohë shtesë për përpjekjet e ankëtës dhe pastrimit, ne jemi plotësisht të angazhuar dhe të përkushtuar drejt përmirësimit të

efikasitetit dhe efektivitetit të përpjekjeve tona. "Tha Sasha Obradović, drejtorit i Qendrës së Veprimit ndaj Minave në Bosnjë dhe Hercegovinë (BHMCA).

"Ky takim është gjithashtu një mundësi për ne që të zbulojmë Strategjinë tonë të Veprimit ndaj Minave në veprimin ndaj minave duke përfshirë arsimin dhe pastrimin e rrezikut të minave dhe ndihmën ndaj të mbijetuarve nga minat tokësore.

Në takim partnerët tanë në bashkësinë ndërkombëtare do të mësojnë se si ata mund të kontribuojnë drejt arritjes së asaj që ne kemi vendosur të bëjmë gati dy dekada më parë, në mënyrë që brezat e rinj të mos jetojnë nën kërcënimin e vazhdueshëm të minave anti-njeri - shtoi drejtori i BHMCA.

Ky grumbullim i madh është i

## Bosnjë-Hercegovina do të organizojë dialog kombëtar mbi pastrimin e minave

mundur falë fondeve të ofruara nga Këshilli i Bashkimit Evropian, i cili miratoi një vendim për të mbështetur shtetet e ndotura nga minat që janë palë në Konventë, për të adresuar angazhimet e ndërmarrura sipas traktatit.

Që nga viti 1996, Bashkimi Evropian ka siguruar më shumë se 46 milionë euro për programet e çminimit vetëm në Bosnje dhe Hercegovinë. Vetëm pak javë më parë, BE dhe BHMCA nënshkruan dy kontrata të reja të veprimit ndaj minave për të përmirësuar vlerësimin e ndotjes së minave tokësore të BH dhe për të përmirësuar raportimin.

Sfondi: Një vendim i marrë nga organi i Shteteve Anëtare të Konventës zgjati afatin fillestar të pastrimit të minierave të Bosnje-Hercegovinës deri më 1 mars 2019. Në prill 2018, autoritetet e BiH-së, megjithatë paraqitën një kërkesë të dytë për ta vazhduar atë afat deri më 1 mars 2021.

**MBROJTËSI U OPERUA NË GJU**

Vetëm katër minuta në ndeshjen e tij të parë si titullar me Kombëtaren shqiptare, në miqësoren ndaj Jordanisë dhe më pas një dëmtim i rëndë. Qendërmbrojtësi 20-vjeçar, Enea Mihaj, i cili është me origjinë nga Berati dhe luan sezonin e



**U dëmtua me Kombëtaren, Mihaj 2 muaj larg futbollit**

tij të dytë në Superligën greke me Panetolikosin, i është nënshtruar operacionit në gju dhe do të jetë jashtë fushave për të paktën 2 muaj. Lajmin e konfirmuan dje mediat greke,

duke iu referuar burimeve zyrtare pranë klubit që përfaqëson qytetin e Agrinjos në Greqi, një vend ku banojnë me mijëra emigrantë shqiptarë. Mihaj konsiderohet si një nga mbrojtësit më

premtues të kampionatit grek dhe FSHF-ja e bindi për të veshur fanellën kuqezi, pasi kishte interes nga Federata e Futbollit të Greqisë. Lojtari disponon edhe pasaportë greke, pasi ka lindur në vendin helen, pikërisht në Rodos.

Mesfushori i Levantes po bën mjaft mirë në Spanjë, ndërsa interes për të ka shfaqur edhe Interi

**Bardhi: Sadiku miku im, largimi i Ronaldos ka dëmtuar La Ligën**

*Shqiptari i Maqedonisë, në një rrëfim 360 gradë*



Jeton Selimi

Dy golat e shënuar sezoin e kaluar ndaj Barcelonës ishin vula e Enis Bardhit për të treguar se një futbollit i madh po rritet në futbollin spanjoll. 23-vjeçari shqiptar, që luan me Levanten në kampionatin spanjoll dhe me Kombëtaren maqedonase, po kalon një moment mjaft të mirë, duke u kthyer në një protagonist të Levante, ku edhe shënoi gol në takimin e fundit të kampionatit. Në një intervistë për ekskluziv për "VipSport.al", Bardhi ka rrefyer ndeshjen e të luajturit përballë lojtarëve si Mesi apo Ronaldo, ndërkohë që tregon edhe objektivat që Levante dhe Maqedonia kanë. Sakaq, Bardhi ka treguar edhe lidhjen e ngushtë me Sadikun, si edhe ka folur për merkaton.

**Enis, ia nisim nga Kombëtarja. Sa mund të ecë Maqedonia në Ligën e Kombeve me grupin aktual?**

Besoj se kemi shumë kualitet në ekip dhe jemi në një rrugë shumë të suksesshme, shpresoj të vazhdojmë kështu. Kemi edhe 2 ndeshje në vijim, shpresoj të fitojmë dhe të bëjmë paraqitje të mira.

**A mendoni se Maqedonia mund të arrijë në Europlan nga ky kompeticion, duke menduar se ka edhe "Play Off" dhe finale para Europianit?**

Besoj se duhet të shkojmë shkallë-shkallë, ndeshje pas ndeshjeje dhe të kemi përqen-



drim sa më shumë për ndeshjen e radhës. Ky është një shans shumë i madh për ne si shtet, pasi kurrë më herët nuk kemi pasur mundësi që nëpërmjet Ligës së Kombeve të jemi afër Europianit. Shpresoj të marrim më të

mirën dhe të shkojmë aty ku kemi qëllimin.

**Po luani në sezonin e dytë në La Liga. Na rrëfte pak, si është të luash kundër Mesit apo Ronaldos sezonin e kaluar? Me të vërtetë ishte ëndrra ime që të transferohesha në La**

Liga dhe falënderoj Zotin që arrita deri atje. Edhe ata janë njerëz si ne, por kualiteti është shumë i madh dhe ky është dallimi. Ata janë dy futbollistë më të mirë në botë dhe nuk krahasohen me asnjë. Është kënaqësi t'i shohësh në fushë dhe akoma më shumë të luash ndaj tyre.

**Sezonin e kaluar, Barcelona postoi foto krahas Mesit. A ju bëri përshtypje?**

E kam parë atë foto dhe kam qenë shumë i çuditur. Kur shoh nga ato foto me të tilla krahasime në faqen e Barcelonës, më jep motiv shtesë të jap sa më shumë të mundem. **Si ndihesh kur të krahasojnë me ta, ose kur dëgjojnë në merkato se ka interes nga Interi?**

Është kënaqësi kur dëgjoj këto krahasime dhe më jep më shumë motiv e më shton dëshirën që të përmirësohem. Çdo lojtar, çdo ditë tenton të jetë më i mirë, po ashtu edhe unë. Sa i përket Interit, jam shumë mirë këtu ku jam te Levante dhe jam i përqendruar në këtë sezon.

**A mendon largim të mundshëm nga Levante dhe ku ke dëshirë të vazhdojë karrierën?**

Kam ardhur këtu të bëj mirë dhe të kompletosh si lojtar. Nuk i dihet kurrë futbollit dhe shpresoj të jem shëndosh e mirë. Nuk e di ku mund të shkoj. Më pëlqen të shoh futboll dhe ndoshta një ditë do të doja t'i bashkohesha një ekipi që luan në Ligën e Kampionëve. **Si është marrëdhënia juaj me Sadikun?**

Shumë e mirë me të vërtetë. Shihemi bashkë dhe bëjmë bashkë ushtrime në stërvitje. Edhe kur jemi pushim rrimë bashkë dhe është një kënaqësi kur ke një futbollist shqiptar dhe flet të njëjtën gjuhë me të. **Objektivi i Levantes këtë sezon?** Objektivi ynë është qëndrimi në La Liga që të arrijmë 42 pikë të mundshme sa më shpejt dhe nëse i arrijmë, do të shohim për mesin e tabelës dhe ndoshta edhe për më shumë. Veç nëse arrijmë ato pikë mund të ndryshojnë objektivat.

**A e dëmtun futbollin spanjoll largimi i Ronaldos?**

Mendoj se e dëmtun, pasi imazhi i Ronaldos është një imazh për kampionatin dhe me largimin tij, ka rënë pak reklama. Megjithatë, nuk mund të themi se nuk do të ketë një Ronaldo tjetër ose një lojtar si Ronaldo. La Liga mbetet La Liga dhe ka e do të ketë futbollistë që e rrisin nivelin e futbollit.

**Cila skuadër të duket favorite për titullin kampion?**

Favorit mendoj se është Barcelona dhe Atletico Madrid, por natyrisht edhe Real. Nëse Sevija vazhdon me këtë ecuri, siç po ecën tani, besoj se do të ketë surpriza.

**Imazhi në mediat shqiptare dhe ato spanjolle. Si ndihesh kur di se ke marrë kaq popullaritet në disa vende?**

Është kënaqësi pasi më herët nuk kam pasur këtë mundësi që të njihesha dhe atje dhe është kënaqësi të ndjej komente pozitive nga shqiptarët e Shqipërisë dhe realisht është shumë kënaqësi.

**REVOLUCIONI KA NISUR**

Vetëm 3 fitore në 11 ndeshje, 2 barazime dhe plot 6 humbje. Për të përshkruar vitin 2018 të Gjermanisë mjaftojnë këto shifra. Në 6 ndeshje zyrtare gjermanët kanë shënuar 3 gola dhe kanë pësuar 9. Kombëtarja e trajnerit Lëv mori një goditje të fortë në Rusi dhe ende nuk po arrin ta marrë veten, siç e vërtetoi edhe humbja e fundit me Francën. Në Ligën e Kombeve, Gjermania rrezikon të zbret nga grupi i saj, por në raport me humbjen e turpshme 3-0 me Holandën, në Francë skuadra u pa më e gjallë dhe më solide. Në fakt, ishte një skuadër krejt ndryshe, sepse trajneri Joakim Lëv kishte bërë 5 lëvizje në

**Viti i errët i Gjermanisë, Lëv rinon skuadrën**



formacion, pra kishte ndryshuar 50% të grupit. Ai kishte hequr nga formacioni Hektor, Boateng, Myler, Çan dhe Uth, duke i zëvendësuar me Shulc,

Syle, Kherer, Gnabri dhe Sanë. Kështu, 10 lojtarët që ishin në fushë dje në mbremje, përveç portierit Nojer, të gjithë bashkë bënë 23 vjet më pak se ata që luajtën me Holandën. Trajneri Lëv ka nisur kështu ndryshimin e generatave në kombëtare, aq shumë të kërkuar nga shtypi dhe tifozët. Për këtë arsye, humbja me Francën kishte një shije ndryshe nga ajo me Holandën apo dhe eliminimi nga Botërori. Në Francë zbriti në fushë Gjermania e së ardhmes, që ka në përbërje të rinj të talentuar, të motivuar dhe ambiciozë. "Paraqitja ish-

te shumë e mirë, sepse të luash kështu dy ditë pas asaj humbjeje të shëmtuar me Holandën, është fantastike. Kishim kurajë dhe sulmuam, duke treguar se kemi individualitete. Humbja ishte e pamërituar", - tha trajneri Lëv pas ndeshjes. Përveç skuadrës, edhe trajneri dha sinjale të rëndësishme. Të shumtë janë në Gjermani ata që kanë dyshime, nëse është Lëv njeriu i duhur për rilindjen, pasi është shumë i lidhur me lojtarët që e shpallën kampion botë. Në ndeshjen e Francës, që pritej t'i kushtonte stolin, ai u tregua i guximshëm dhe u besoi të rinjve. Më shumë se trajneri, tani në shënjestër është vëne Myleri. Sane është 7 vjet më i ri se ai dhe ka luajtur shumë më mirë.

**MISTER LI**

**ISH-PRESIDENTI TË MILANIT I BLOKOHET PASAPORTA**


Jonghong Li erdhi me shumë bujë te Milani dhe falë "pasurisë" së tij, pretendohet që të ngrinte kuqezinjtë në nivelet më të larta të futbollit Botëror. Megjithatë, asgjë nuk shkoi ashtu siç duhet, ku përveç dështimeve në rezultate dhe mungesës së blerjeve të lojtarëve të mëhën, Milani po përballlet edhe me sanksione të ndryshme nga UEFA. Milani vendosi që të largonte kinezët dhe të afronte në skuadër shokërinë amerikane Eliot. Mesa duket, ky ka qenë ndër vendimet më të mira të kuqezinjve në vitet e fundit, duke qenë se ish-pronari Li Jonghong po përballlet me probleme financiare në Kinë. Gjeveria kineze i ka bllokuar pasaportën dhe nuk e lejon që të largohet nga vendi. Shkak për këtë, janë bërë borxhet e shumta të akumuluar në vitet e fundit, ndërkohë që në Itali, ai prezantohet si një nga më të pasurit, aq sa arriti të merre edhe drejtimin e kuqezinjve

**SKOLLS: TE KY MANÇESTER DHE MESI DO TA KISHTE TË VËSHITRË**

Sulm i drejtpërdrejtë i ish-mesfushorit të shquar të Mançester Junajtidi, Pol Skolls, për skuadrën aktuale, që është shumë larg lavdisë së "Djajve të kuq". Në një prononcim për "ESPN", Skolls e ka kritikuar ashpër grupin e lojtarëve, protagonistë negativë këtë sezon me Mançesterin. "Dua të them atë që mendoj, nuk kam pse të fshesh asgjë. Mançester Junajtidi mund të blejë edhe Mesin në këtë moment, por edhe ai do të vuante me këtë skuadër. Duket se çdo lojtar që vjen në skuadër, ka probleme të adoptohet me lojën e Mançesterit, kështu që e njëjta gjë do të ndodhte edhe me Mesin", - u shpreh ish-mesfushori i njohur anglez, pa e përmendur emrin e trajnerit Zhoze Mourinjo si përgjegjës për këtë situatë.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Me të nxjerrin një tapë.
- Inicialet e Kleeë piktor.
- Qiriaçi aktor.
- Etikë pa kufij.
- Merren për shembull.
- Fund janari.
- Janë edhe ata të skuadrës.
- Ortolani kompozitor.
- Ushtrrohej edhe nga bukanierët.
- Në krye të sondazheve.
- Janë të ndaluar në kthesë.
- Ente Rajonale Civile.
- Gjermania në tabela.
- Mund të jetë unik.
- Philippe që qe aktor.
- Një pjesë e pelegrinazhit.
- Gjysmë leader.
- Maten pa zë.
- Janë të përpjeta.
- Qytet anglez.

- Louis, poet surrealist.
- Artet pa re.
- Matet pa kufij.
- Gruaja e Ben Hur.
- Liam i Schindler's list.
- Të parat në orkestër.
- Makina Ibiza.
- Renato, piktor i famshëm italian.
- Mihali këngëtare lirike.

**VERTIKAL**

- Mbyllin fushata.
- Një pjesë e pikturave.
- Janë njëvjeçarë.
- Një ngjyhet në tavolocë.
- Është katolik ai i papës.
- Mbyllin portat.
- Opera e Mascagni-t.
- Tregohet duke bërë masakra.
- Janë atësi prodhuese të fabrikës.
- Një gjuajtës francez.
- Është porti i Durrësit.
- Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
- Pak pirografi.
- Një pjesë e aerobisë.
- U vodhi zjarrin perëndive.
- Premtojnë të bëhen asa.
- Mbeten në fund.
- Rreth pa ekstreme.
- Rendi pa zë.
- Është veshje tahitianësh.
- Tase e volejbolit.
- Është shahu i fundit.
- Kim... Stuart aktor.
- Fritz regjisori.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Një pjesë e ansambllit.
- Ditong teatral.
- Të parat në stacion.
- Qendër në tour.
- Mbarojnë fare.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Harris aktor.
- Termocentrali i shkurtër.
- Organizata me koska.
- Një tufë bagëtitsh.
- Inicialet e Redford.
- Kështu thonë se bëhet ai që mërziut.
- Scarlet e Bashkë e erën.
- Elvira aktore.
- Është Panorama që ke në dorë.
- Ushtojnë nga "ola".
- Shtet aziatik.
- Është ministri.
- Në radhtë të parë.
- G... për njerëzit e FBI.
- Makina Micra.
- Mund të jetë proteste.
- Pasur pa kufij.
- Gjika e Dora d'Istria.
- Të fundit në dhjetor.

**VERTIKAL**


- Umberto që shkroi Baudolino.
- Bertë këngëtare italiane.
- Fillojnë një temë.
- Një garë në hipodrom.
- Qe burri i parë.
- Një ndriçues.
- Bëjnë shirit me shi.
- Dha fillin Tezetur.
- Vihen për të mbyllur.
- Para Saint-Germain në futboll.
- Qëllojnë në një vend.
- Është dosja e të pandehurit.
- Janë përmasat.
- Mbush në kufij.
- I bëjnë duart me ar.
- Inicialet e dali piktor.
- Fillojnë argumentin.
- Makina Ibiza.
- Emri i Einstein.
- Ndriçojnë rrugët.
- Kim që qe aktore.
- I hedh i dorzuar.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Ishin rapsodët e akcjeve.
- Fund shkurti.
- Van der portier holandez.
- Fillojnë masat.
- Inicialet e Rohmer.
- Fillojnë teorikisht.
- Numerë i shkurtër.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

|   |   |   |   |   |   |  |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|--|---|---|---|
|   | 9 | 8 |   |   |   |  | 6 |   |   |
| 5 | 6 |   | 3 | 7 |   |  | 8 |   |   |
| 2 |   |   | 5 |   |   |  | 9 |   |   |
|   |   |   |   |   |   |  | 9 |   |   |
|   |   |   |   | 4 |   |  | 1 | 5 | 8 |
|   |   |   | 2 |   |   |  |   |   |   |
|   |   |   |   |   |   |  | 5 |   |   |
| 4 |   |   |   | 3 | 6 |  | 7 |   |   |
| 7 | 3 | 4 |   |   |   |  | 8 |   |   |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 5 | 6 | 2 | 3 | 7 | 9 | 4 | 8 |
| 7 | 9 | 2 | 8 | 1 | 4 | 5 | 6 | 3 |
| 8 | 3 | 4 | 9 | 5 | 6 | 7 | 2 | 1 |
| 6 | 4 | 5 | 7 | 8 | 2 | 1 | 3 | 9 |
| 2 | 1 | 8 | 4 | 9 | 3 | 6 | 5 | 7 |
| 9 | 7 | 3 | 1 | 6 | 5 | 4 | 8 | 2 |
| 3 | 2 | 7 | 5 | 4 | 9 | 8 | 1 | 6 |
| 5 | 6 | 1 | 3 | 7 | 8 | 2 | 9 | 4 |
| 4 | 8 | 9 | 6 | 2 | 1 | 3 | 7 | 5 |

*Argëtim filozofik*

- Duhet të shfrytëzohet mirë koha, sepse jeta nga koha përbëhet.
- S'ka gjë më të keqe se të përqeshurit, sepse më shumë prek të mirët se të këqijtë.
- Njollat që i ngjiten trupit tonë lahen me ujë; njollat e shpirtit s'ka gjë që i pastrojnë.
- Virtuti i bën të dashur (me njëri — tjetrin) njerëzit e mëdhenj, njerëzit e zakonshëm — dëfrimi dhe zbatimja, të këqijtë — vagabondazhi dhe delikti.

*Thënie të mençura*

- Duhet shumë mend që të mund të shoqërohesh me njerëz pa mend.
- Mos shkruaj gjë kur je me nerva; sepse, kur plaga e gjuhës së mëmës më e keqe se e shpatës, mendo çfarë mund të jetë ajo e pendës.
- Kot përpiqet mendja, kur nuk mund të arrijë gradën e lartë të ndjenjave.
- Fjala më elokumente është ajo konkluzioni i së cilës kuptohet që nga fraza e parë e qëllimi nëpër brendinë e saj, kur duket në formë solide.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

|    |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |
|----|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| 3  | P | U  | S  | I  | 15 | 2  | 3  | 5  | 7  | 3  |    |
| 2  | 4 | 8  |    | 4  | 7  | 8  | 6  | 9  | 1  |    |    |
| 6  | 1 | 2  | 3  | 10 | 9  | 10 | 4  | 1  | 11 | 8  | 5  |
| 12 |   | 3  | 8  | 11 | 7  | 4  | 8  | 13 | 8  | 5  |    |
| 5  | 4 | 1  | 3  | 8  | 11 | 7  | 16 | 7  | 13 | 8  |    |
| 10 |   | 3  | 8  | 5  | 8  | 5  | 1  | 11 | 8  | 5  |    |
| 5  |   | 10 | 6  | 8  |    | 1  | 5  |    | 5  | 7  | 18 |
| 1  | 8 | 4  |    |    | 3  | 4  | 8  | 11 | 1  | 13 | 10 |
|    | 4 | 1  | 17 | 12 | 8  | 10 | 4  |    | 6  | 1  | 9  |
| 6  | 5 | 1  | 9  | 10 | 5  |    | 10 |    | 2  | 15 | 10 |
| 4  | 2 | 16 |    |    | 8  |    | 2  | 15 | 10 |    |    |
| 4  | 1 | 17 | 12 | 8  | 4  | 18 |    |    | 5  | 8  |    |

- Kot përpiqet mendja, kur nuk mund të arrijë gradën e lartë të ndjenjave.
- Fjala më elokumente është ajo konkluzioni i së cilës kuptohet që nga fraza e parë e qëllimi nëpër brendinë e saj, kur duket në formë solide.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | L | E | X | S | G | P | O | A | Z | I |   |   |
| M | I | S | H | N | D | O | R | E | S | H | I | R |
| A | R | A | M | O | G | O | A | U | T | O |   |   |
| M | K | I | M | N | O | V | A | K | O | N |   |   |
| T | S | E | R | I | A | L | I | A | R | T | I |   |
| P | R | E | T | E | N | D | I | M | I | O | K |   |
| R | O | N | A | L | D | O | I | G | A | E |   |   |
| M | A | L | E | N | G | A | O | R | E | T |   |   |
| B | A | T | A | R | I | A | T | E | R | O | R |   |
| I | R | O | N | A | C | E | M | Y |   |   |   |   |
| L | I | R | I | K | E | P | A | R | O | D | I | A |
| L | O | I | R | A | C | O | R | O | T | K | N |   |

**FJALËKRYQI (1)**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| F | A | L | L | I | K | F | N | D | O | R | A |   |
| A | D | A | M | P | A | L | T | M | I | N |   |   |
| L | E | M | T | A | B | E | A | T | E | R | O | R |
| A | T | K | A | P | I | T | U | L | L | I | M | I |
| N | A | M | A | R | I | N | A | R | I | I | L |   |
| G | R | E | M | I | N | A | U | E | F | E |   |   |
| A | R | I | F | D | E | N | T | I | S | T |   |   |
| P | I | K | A | T | E | S | E | R | T | E |   |   |
| C | I | T | A | T | E | M | E | T | E | O | R | E |
| O | S | Z | R | A | M | T | R | T |   |   |   |   |
| S | H | T | E | P | I | T | E | L | E | J | A |   |
| A | E | K | A | M | I | V | I | S | A | R | I |   |

**FJALËKRYQI (2)**

